KQZ
U PROTOKOLLUA
NR 2675 PROT
DATE 25.3.2021

# Raport Përfundimtar i Audituesit mbi Verifikimin e Veprimeve në Bazën e të Dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile

Përgatiti:
Roland Kërçuku
Audit Teknicien

Lënda : **Raport Përfundimtar i Auditimit**

Drejtuar : **Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**
**Komisioneri dhe Nënkomisioneri Shtetëror për Zgjedhje**

Të nderuar anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në zbatim të vendimit Nr. 1, datë 19.10.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për emërimin e auditit teknicien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve, për zgjedhjet të datës 25 Prill 2021" dhe udhëzimit Nr.2, datë 28.12.2012 të KQZ "Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknicien për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe në sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV), ju paraqes më poshtë raportin e auditimit të kryer për periudhën ekstraktet e pare date 3 Tetor 2020 dhe ekstraktin e dytë date 1 Nëntor 2020.

Verifikimet paraprake mbi bazën e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe ekstraktet e përbërësve zgjedhore e listat e zgjedhësve të gjeneruara nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile(RKGJC) në zbatim të "Kodit Zgjedhor", Ligjit "Për Gjendjen Civile", janë kryer duke përdorur metodën e testimit dhe krahasimit nëpërmjet për këmbimeve te përcaktuara ne Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile".

Për përmbushjen e misionit te ngarkuar kam vlerësuar metodat dhe parimet e përdorura për kontrollin e dublimeve ne listat e zgjedhësve sipas procedurave te parashikuara ne aneksin nr.1 te Udhëzimit te Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile", respektimin e kriterit ligjor për numrin e zgjedhësve për qendrat e votimit si dhe kriteret e tjera te vendosur ne ligj.

Përgjegjësia e audituesit është te verifikoje përputhshmërinë e veprimeve te kryera nga DPGJC me rregullat e përcaktuara ne Kodin Zgjedhor, ligjin për "Gjendjen Civile" dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore mbi bazën e te dhënave te Regjistrit Kombëtar te Gjendjes Civile.

## Përmbajtje

1. Hyrje ....................................................................................................................4
2. Baza Ligjore ............................................................................................................6
3. Situata e përgjithshme e punës dhe të dhënat bazë paraprake ....................................8
4. Administrimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile ..................................................10
5. Administrimi i procesit sipas detyrimeve ligjore .........................................................11
6. Verifikimi i integritetit dhe problematikat në Listën e Zgjedhësve ...............................12
6.1. Shtetas të pa identifikuar, me kode banimi jo të rregullta ......................................12
6.2. Shtetas brenda së njëjtës familje që votojnë në QV të ndryshme ............................14
6.3. Ndryshimi apo Përditësimi i adresave ...................................................................15
6.4. Ndryshimi i QV ...................................................................................................20
6.5. 7 Regjistrimi i Votuesve me vendbanim jashtë vendit ..............................................21
7. Opinion ................................................................................................................23
8. Shtojca .................................................................................................................24

# 1. Hyrje

Ne kuadër te zgjedhjeve, sipas dekretit Nr.11700 të Presidentit të Republikës, datë 06.09.2020, do të zhvillohen më datë 25 Prill 2021 nëpërmjet vendimit Nr. 1, datë 19.10.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për emërimin e auditit teknicien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve është bere caktimi i auditit teknicien është bere caktimi im si Auditues Teknicien.

E gjithë puna është bazuar dhe do të bazohet në përcaktimet e Udhëzimit nr. 2, datë 28.12.2012 të KQZ "Për Miratimin e Rregullave të Veçanta, për Kushtet e Kontratës dhe Kryerjen e Auditimit, nga Auditët Teknicien, për Verifikimin e Veprimeve në Bazën e të Dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) dhe në Sistemin Elektronik të Verifikimit dhe Regjistrimit Të Zgjedhësve (SEV)"; i cili në nenin 7 përcakton objektin, në lidhje me verifikimet e veprimeve në bazën e të dhënave, si më poshtë:

*Objekt i auditimit nga auditët teknicien është kontrolli i përputhshmërisë së veprimeve të kryera për hartimin e listave të zgjedhësve nga zyrat e gjendjes civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me rregullat dhe afatet e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, ligjin për Gjendjen Civile si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre të nxjerra nga Ministri i Brendshëm.*

Me qëllim realizimin e kësaj objektive, puna jonë është përqendruar në verifikimin e të gjithë elementëve të listave të zgjedhësve të gjeneruara nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, në lidhje me ekzistencës dhe saktësisë e të dhënave për të gjithë ata shtetas të cilët gëzojnë të drejtën që të jenë zgjedhës, sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015, ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020 dhe ligjin nr. 118/2020 datë 05.10.2020.

Ne zbatim te detyrës te caktuar kontrolli i ekstraktit te përbërësve zgjedhor përfshin ne përgjithësi:

- Njohjen dhe verifikimi i procedurave të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile pranë Ministrisë te Brendshme, Zyrave e Gjendjes Civile pranë Bashkive dhe Njësi Administrative, si dhe të strukturave të tjera të pushteti vendor, të cilat direkt apo indirekt ndikojnë në përgatitjen e listës së zgjedhësve.

- Verifikimi mbi masat e ndërmarra për sigurimin e integritetit te bazës së të dhënave dhe mbi procedurat e mirëmbajtjes dhe administrimit të sistemeve të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.
- Kryerjen e verifikime mbi veprimet e kryera nga shërbimi i Gjendjes Civile të cilat ndikojnë në elementët zgjedhorë, sipas përcaktimeve të nenit 45, të ligjit nr. 10019 me date 28.12.2008 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE" i ndryshuar.

## 2. Baza Ligjore

- Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015, ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020 dhe ligjin nr. 118/2020 datë 05.10.2020.
- Ligji Nr.10129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", i ndryshuar me ligjin Nr.6/2012, datë 02.02.2012, ligjin Nr.130/2013 datë 25.04.2013, ligjin Nr.134/2016 datë 22.12.2016 dhe ligjin Nr.69/2018 datë 11.10.2018.
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore"
- VKM Nr.365, datë 11.6.2004 "Për krijimin e mënyrën e mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe për rregullat e shfrytëzimit të teknikës dhe rrjetit informatik".
- VKM Nr.673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar me Vendimin e KM Nr.36, datë 24.01.2018, Vendimin e KM Nr.88, datë 14.02.2018 dhe Vendimin e KM Nr.448, datë 26.07.2018.
- VKM Nr. 945, datë 2.11.2012 "Për Miratimin e Rregullores 'Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore'"
- VKM Nr. 710 datë 21 gusht 2013 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit" i ndryshuar,
- VKM 222 date 26.4.2018 "Për miratimin e listës se infrastrukturave kritike te informacionit dhe listës se infrastrukturave te rëndësishme te informacionit"
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.289, datë 10.09.2020 "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë".
- Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 "Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 "Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike".
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile".

- Udhëzimit të KQZ-së Nr.2, datë 28.12.2012 "Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknicien për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe ne sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV)

## 3. Situata e përgjithshme e punës dhe të dhënat bazë paraprake

Duhet theksuar që në fillim se me marrjen e detyrës kemi zhvilluar takimin e parë më datë 27 tetor me zyrtarët kryesorë të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, për të siguruar kushtet minimale të punës dhe për të marrë informacionet bazë të nevojshme për zhvillimin e punës sonë. Që në takimin e para dhe në vazhdim janë kërkuar

1. Përcaktimi i një posti pune pranë DPGjC dhe aksesi në Sistemin Informatik të Regjistrit Kombëtar të Shtetasve, dhe/apo sisteme të lidhura me të.
2. Kopje zyrtare të Extraktit të Listës së Zgjedhësve dhe statistikat përkatëse.
3. Numri i Dublimeve të dyshuara
4. Informacion mbi procesin e përditësimin të adresave të shtetasve
5. Informacion mbi procedurat e realizuara në lidhje me reflektimin në Regjistrin Kombëtar të Shtetasve (RKSH) të dekreteve të Presidentit të Republikës për dhënie/marrje shtetësie
6. Statistika mbi të dhënat për QV-të të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore.

Dëshiroj të theksoj që në fillim të këtij raporti, që Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGjC), nuk ka qenë shumë bashkëpunuese, si më poshtë:

a. Në lidhje me përcaktimin e **postit të punës dhe mundësinë për akses në RKGjC është realizuar më datë 11 Nëntor 2020**, rreth 20 pas njoftimit zyrtar të emërimit tim.
b. ***Në shumë raste DPGjC ka kthyer përgjigje me shumë vonese ose në ndonjë rast edhe nuk ka kthyer përgjigje ( Shkresa me numër protokolli të MB R-84 datë 05.11.2020)***.
c. ***DPGjC disa herë i është shmangur përgjigjeve së pyetjeve tona me citime të përgjithshme ligjore apo me përgjigje sipërfaqësor.***
d. **Në Disa raste ka dhënë edhe informacione të pa sakta**, të cilat më vonë, pas këmbënguljeve tona është përpjekur ti korrigjojë.
e. Vetëm më datë 02 Nëntor 2020, pra rreth 15 pas emërimit tim, kam marrë ekstraktet e përbërësve zgjedhorë të gjeneruara në datat 3 Tetor 2020 dhe 1 Nëntor 2020 si edhe statistikat e para nga DPGJC.
f. Gjatë auditimit ka qenë **e pamundur të bëhet një vlerësim i plotë i procesit të gjenerimit të ekstraktit zgjedhor** nga baza e të dhënave të RKGJC për

shkak të pamundësisë për të qenë i pranishëm gjatë ekzekutimit të këtij procesi. I gjithë procesi i punës për gjenerimin e ekstraktit zgjedhor realizohet vetëm nga operatori ekonomik i mirëmbajtjes së sistemit (XION).

Gjithashtu vlen të theksohet se **afatet ligjore të gjenerimit të ekstrakteve dhe listës përfundimtare janë zbatuar me korrektësi nga DPGjC.**

Bazuar në statistikat e përgatitura nga DPGjC-së për të ekstraktin e parë të datës 3 Tetor 2020 dhe Listës Përfundimtare (LP) të gjeneruar në datë 15 Mars 2021, kemi të dhënat e përgjithshme si më poshtë:

| Nr. | Përshkrimi | Vlera Ek_1 | Vlera LP |
|---|---|---|---|
| 1 | Numri i përgjithshëm i shtetasve me të drejtë votimi | 3,608,169 | 3,592,828 |
| | a. Meshkuj | 1,823,803 | 1,812,442 |
| | b. Femra | 1,784,169 | 1,776,427 |
| 2 | Të pa përfshirë në lista nga të cilët: | 173,295 | 3,959 |
| | a. Shtetas mbi 100 vjeç të pa përfshirë | 3,249 | 2,861 |
| | b. Shtetas të pa përfshirë sipas udhëzimit nr. 225 datë 11.05.2016 | 940 | 1,098 |
| | c. Të tjerë me numër QV jashtë limitit | 169,106 | 0 |
| 3 | Numri i Votuesve në listë | 3,434,874 | 3,588,869 |
| 4 | Numri i QV-ve në total | 5,386 | 5,199 |
| 5 | Numri i QV-ve mbi 1,000 zgjedhës | 106 | 0 |
| 6 | Numri i QV-ve nën 300 zgjedhës, nga të cilat | 419 | 18 |
| | a. 20-300 zgjedhës | 257 | 18 |
| | b. Më pak se 20 zgjedhës | 162 | 0 |
| 7 | Numri i zgjedhësve me numër banimi 000 888 999 | 2,101 | 53 |
| 8 | Dublime të dyshuara në listë, nga të cilat | 946 | 0 |
| | a. Dublime të dyshuara brenda ZGJC | 811 | 0 |
| | b. Dublime të dyshuara jashtë ZGJC | 135 | 0 |

Në një vështrim të përgjithshëm nga treguesit e mësipërm rezulton se:

1. Kemi zvogëlim të numrit të shtetasve me të drejtë vote nga Ek_1 në LP me 15,341 zgjedhës, të cilët mbi 95% janë shtetas të cilët kanë ndërruar jetë.

2. DPGjC dhe Bashkitë kanë eliminuar të gjitha qendrat e votimit me më pak se 300 votues, me përjashtim të atyre në institucionet e veçanta.
3. Nga ekstrakti në ekstrakt ka pasur një zvogëlim të ndjeshëm të numrit të shtetasve të pa përfshirë në listën e zgjedhësve, deri sa në Listën Përfundimtare nuk ka asnjë shtetas që përmbush të drejtën ligjore për të qenë zgjedhës.

## 4. Administrimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile

Baza e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (referuar si) siç përcaktohet në Kodin Zgjedhor shërben si burim bazë ku ruhen, administrohen dhe përpunohen përbërësit zgjedhorë të shtetasve shqiptarë, individualisht dhe në tërësi. Nisur nga rëndësia e madhe që ka RKGJC është e nevojshme të garantohet që kjo bazë të dhënash administrohet, ruhet dhe përpunohet në mënyrë sa më të sigurtë dhe transparente.

Përdoruesit e sistemit, qofshin këta në nivel të ndërfaqes të programit apo në nivel databaze, janë ata të cilët kanë të drejta për të bërë ndryshime mbi të dhënat e përbërësve zgjedhorë të shtetasve në varësi të rolit të tyre. Për shkak se këto veprimeve mund të rezultojnë në tjetërsim të të dhënave dhe modifikime të jashtëligjshme është i rëndësishëm garantimi i administrimit të përdoruesve në sistem, duke përfshirë të gjithë hapat e ndjekur që nga krijimi, modifikimi, çaktivizimi dhe gjurmimi i veprimeve të tyre, si një element i rëndësishëm për sigurinë dhe transparencën. Në takimet e zhvilluara pranë DPGJC dhe komunikimeve në formë elektronike është synuar që të verifikohen informacionet që kanë të bëjnë me administrimin e përdoruesve dhe gjurmimin e veprimeve të tyre.

Nga ana e përfaqësuesit të DPGJC raportohet që krijimi i përdoruesve në sistem bëhet vetëm nëpërmjet komunikimit shkresor dhe nuk ka fshirje të përdoruesve por vetëm çaktivizim të tij. Raportohet që lista e përdoruesve përfshin punonjësit e ZGJC- të cilët kanë të drejta të plota për të realizuar përditësimin e elementeve të gjendjes civile të personit duke përfshirë edhe përbërësit zgjedhorë, punonjësit e DPGJC- në rolin e administratorit të përdoruesve të sistemit të RKGJC-së dhe të verifikimeve të punës që kryhet nga punonjësit e ZGJC-ve në sistem por pa të drejta përditësimi informacioni të shtetasve, përdoruesit pranë ambasadave apo zyrave konsullore të Republikës së Shqipërisë në vende të ndryshme të botës - por pa të drejte ndryshimi të informacionit zgjedhor të shtetasve shqiptare.

Nga informacioni i marrë na rezulton se stafit të DPGJC i mungon mundësia për realizimin e shumë raporteve informues dhe statistikave, kjo për arsye se ose është e drejte ekskluzive e mirëmbajtësit/administruesit të sistemit ose për mungesën e kapaciteteve të duhura për të kryer raporte te ndryshme, dhe si rrjedhim ne shpesh informacionet e kërkuara i kemi marrë me vonesë dhe jo të plota.

Rezulton që nga ana e DPGJC ka një procedurë se si administrohen përdoruesit në sistem, rolet dhe të drejtat e tyre. Nisur nga kjo është synuar që të bëhet verifikimi se si është procesi dhe hapat faktik që ndiqen për administrimin e tyre. Nëpërmjet aksesit në ndërfaqen e programit të RKGJC është bërë kontrolli i listës të drejtave dhe roleve që ekzistojnë në sistem. Ndonëse nga ana e DPGJC nuk ka një dokumentim që të bëjë përshkrimet dhe detajimin e tyre, sistemi ka një listë të drejtash, të cilat lidhen me përdoruesin në varësi të profilit qe duam ti japim këtij të fundit. Nga verifikimi i bërë në ndërfaqe rezulton që aty nuk shfaqet momenti se kur është bërë krijimi apo modifikimi i përdoruesit. Nisur nga ky fakt është kërkuar nxjerrja e log-eve nga sistemi që bëjnë të mundur identifikim e këtyre veprimeve.

Në takime raportohet që nga ana e DPGJC se është i pamundur dhe eksportimi dhe vënia në dispozicion i log të cilët bëjnë gjurmimin e veprimeve të bëra nga ana e përdoruesve mbi përbërësit zgjedhorë të shtetasve shqiptarë duke kufizuar kështu mundësitë për analiza sasiore.

***<u>Ritheksoj se nëpërmjet aksesit në konsolën e programit të RKGJC është i mundur vetëm verifikimi i zgjedhësve emër për emër dhe gjurmohet vetëm ndryshimi i fundit.</u>***

## 5. Administrimi i procesit sipas detyrimeve ligjore

Në lidhje me administrimin e procesit të përgatitjes së listës së zgjedhësve konstatohet se:

1. DPGjC ka përgatitur ekstraktin e parë të listës së zgjedhësve më datë 03.10.2020 dhe ekstraktin e dytë më datë 01.11.2020, ekstraktin e tretë në datë 30.11.2020 ekstraktin e katërt në datë 02.01.2021, ekstraktin e pestë në datë 31.01.2021, ekstraktin e gjashtë në datë 28.02.2021dhe Listën Përfundimtare në datë 15.03.2021, afate të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.
2. Në përgjigje të kërkesës për informacion mbi rastet kur ne zbatim te Nenit 50, pika 2 se nga ana e DPGJC janë identifikuar raste te shkeljeve dhe cilat janë masat administrative te ndërmarra. DPGjC konfirmon se "Nuk janë

konstatuar shkelje të cilat të ndikojnë në deformimin e përbërësve zgjedhor te zgjedhësve".

3. Kërkesës sonë për informacion në lidhje me zbatimin e nenit 52 te Kodit zgjedhor mbi "Njoftimin me shkrim i zgjedhësve" nga ana e DPGJC nuk është arritur te provohet me dokumentacion përkatës nëse është realizuar,
4. Ne pamje te pare janë zbatuar përgjithësisht procedurat e udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.298, datë 10.09.2020 "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë", dhe të udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 "Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 "Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike" dhe të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile".

Në lidhje me realizimin e ***procesit të "Njoftimin me shkrim i zgjedhësve", në mungesë të një informacioni zyrtar nga ana e DPGjC-së si dhe në pamundësi për të marrë këtë informacion nga Bashkitë (duke qenë jashtë fushës sonë të veprimit) ne i sugjerojmë Komisionerit dhe nën Komisionerit Shtetëror për Zgjedhje të kërkojë informacion më të detajuar si edhe gjithashtu marrjen e masave për eliminimin e këtij fenomeni.***

# 6. Verifikimi i integritetit dhe problematikat në Listën e Zgjedhësve.

## 6.1. Shtetas të pa identifikuar, me kode banimi jo të rregullta.

Bazuar edhe në analizat e kryera që në vitin 2019, në listat për Zgjedhjet Vendore 2019, fenomeni numrit të banesës (kodi i banimit) 000, 888 dhe 999 pothuajse nuk ekziston më. Në Ek_1 dhe Ek_2 praktikisht kemi vetëm 2,101 shtetas me kod banese të pa identifikuar. Por fakti që për ata zgjedhës të cilët kanë pasur kod banese të pa identifikuar deklarohen kode të rinj të cilët janë mbi nivelet e listave të mëparshme duke arritur deri në kodin 998 krijon dyshime të mëdha për ndryshime fiktive dhe manipulim të vlerave të kodit të banesës për zgjedhësit në fjalë. Fenomen ky i evidentuar dhe ne raportet e auditit teknicien te depozituara dhe kryera në vitin 2019. Rezulton se **175,728** zgjedhës kane kod banese mbi 350 dhe **71,616** zgjedhës më të madh se 500. Detajet për këta shtetas për çdo bashki janë si ne në tabelën e mëposhtme. Nga investigimet e kryera dhe bazuar dhe

ne raportet e 2019 kemi krijuar plotësisht bindjen se procesi i ndërmarrë nga DPGJC për këto kode ka qene totalisht abuziv dhe kodet ne shumicën dërrmuese te rasteve janë kode fiktive, ashtu sikurse kemi edhe votues me kod banimi në objekte jo banuese (objekte social kulturore, arsimore, industriale, etj.).

| Nr. | Qarku | Kod Banese > 350 | Kod Banese > 500 |
|---|---|---|---|
| 1 | Berat | 2,871 | 904 |
| 2 | Dibër | 56 | 35 |
| 3 | Durrës | 22,652 | 10,970 |
| 4 | Elbasan | 16,930 | 9,311 |
| 5 | Fier | 11,370 | 5,010 |
| 6 | Gjirokastër | 1,530 | 269 |
| 7 | Korçë | 32,874 | 12,481 |
| 8 | Kukës | 864 | 101 |
| 9 | Lezhë | 4,999 | 927 |
| 10 | Shkodër | 11,683 | 4,213 |
| 11 | Tiranë | 56,477 | 23,127 |
| 12 | Vlorë | 13,422 | 4,268 |
| **Total** | | **175,728** | **71,616** |

Duke e konsideruar si element me risk te larte kemi kërkuar informacion DPGjC per të gjitha ndryshimet e realizuara mbi kodin zgjedhor 10 shifror, duke kërkuar në veçanti emrin e përdoruesit të Zyrës të Gjendjes Civile që ka kryer veprimin në sistem dhe datën e veprimit.

Bazuar në faktin se DPGjC ka kryer tashmë një proces të përditësimit të adresave, në mënyrë automatike pyetja që shtrohet është kur DPGjC ka identifikuar mbi 2 milion shtetas në banesa dhe ka përditësuar në RKGjC adresat e tyre pse nuk ka saktësuar fillimisht shtetasit me problem historike te kodit te banesave por ne vitin 2018 ka ndërmarrë një operacion te gjere për te zëvendësuar fiktivisht kodet 999, 888 etj. me kode te reja. Kjo pyetje nuk ka marre përgjigje shteruese as gjate raporteve te vitit 2019.

## 6.2. Shtetas brenda së njëjtës familje që votojnë në QV të ndryshme

Bazuar në faktin se DPGjC ka krye përditësimit të adresave, në mënyrë automatike ne kemi analizuar listën zgjedhore për të identifikuar votues brenda familjes të cilët votojnë në qendra votimi të ndryshme.

Nga analiza jonë rezultojnë se shume shtetas të te njëjtës familjeve votojnë në QV të ndryshme. Ne shume raste rreth 30% e këtyre shtetasve janë në QV të tjera me pjesën më të madhe të familjes.

Për këtë arsye ne i drejtuam DPGjC-së pyetjen: "***Sa është numri i shtetasve qe janë brenda një trungu familjar (në kuptim anëtar të së njëjtës familje) që votojnë në Qendra Votimi te ndryshme?***", DPGjC i është përgjigjur

*"Në rast se i referoheni përbërjes familjare ju informojmë se numri i shtetasve që kanë qendra votimi të ndryshme brenda të së njëjtës familje është 576,505. Pjesë e këtij numërimi janë dhe shtetas të burgosur me të drejtë vote / oficerë / shtetas që votojnë në qendra votimi të veçanta, të cilëve u ka ndryshuar ZGjC si dhe QV respektive. Gjithashtu ngelet për t'u sqaruar se pjesë e këtij numërimi është e gjithë familja në rast se njëri prej anëtarëve u ndryshon ZGjC nga të tjerët.*

Ndërsa më datë 21 Dhjetor 2020, në vazhdim të interesimit tonë, DPGjC na informon se "*Aktualisht janë 89.954 familje me pjesëtar që kanë QV të ndryshme dhe janë gjithsej 304.916 shtetas dhe jo 576.505*".

Edhe me këtë korrigjim ky numër është shumë i lartë dhe shqetësues. Për më tepër edhe përgjigjet jo të sakta dhe evazive nga ana e DPGjC përpiqen të krijojë një situatë e cila nuk mund të investigohet. Gjithashtu DPGjC në përgjigjen e datës 18 Dhjetor 2020 sqaron se në numrat e mësipërm përfshihen: i) Numri prej 11,370 shtetasve të burgosur (si edhe ii)1,891 shtetas të tjerë (si p.sh. oficere, ushtare, etj.) të cilët votojnë në QV të veçanta.

Sipas Listës Përfundimtare na rezulton se **46,666 kanë pjesëtar të familjes në QV të ndryshme**. Duke i konsideruar që të gjithë këta persona si anëtarë të një familje të vetme atëherë rezulton se mbi 13,000 familje të jenë në këtë kategori.

Këtu vlen të theksohet se ky problem është ngritur që në raportin e parë, duke i kërkuar Komisionerit dhe nën Komisionerit Shtetëror për Zgjedhje të kërkojë informacion më të detajuar si edhe gjithashtu marrjen e masave për eliminimin e këtij fenomeni.

Si rezultat i kërkesave dhe punës së shërbimit të gjendjes civile nga Ek_1 në LP kemi një ulje me rreth 35% të këtij numri.

### 6.3. Ndryshimi apo Përditësimi i adresave

Nga një sere denoncimesh publike te emisionesh investigative apo dhe shtetasve te ndryshëm te cilët janë përballur me ndryshimin e adresës kemi kërkuar zyrtarisht informacion lidhur me këtë fenomen. DPGjC, na ka bërë me dije në përgjigjen e datës 2 Nëntor se: "**nga data 05 Dhjetor 2019, 3,186,336 shtetasve ju është përditësuar adresa nga ana e shërbimit të Gjendjes Civile**. Bazuar në deklarimin e parë kemi informacionin se 1.806.131 adresa janë ndryshuar në RKGjC nga punonjësit e zyrës së gjendjes civile, me kërkesë të shtetasit, ndërsa 1.380.205 janë ndryshuar nga migrimi i të dhënave."

**Nga ana jonë u konsiderua totalisht i pa saktë deklarimi se 1.806.131 adresa janë ndryshuar në RKGjC nga punonjësit e zyrës së gjendjes civile, me kërkesë të shtetasit** sepse bazuar sipas kësaj përgjigje **rezulton se mbi 15.000 shtetas kanë vizituar zyrat e gjendjes civile çdo ditë** (duke përjashtuar 4 muaj e mbylljes për shkak të pandemisë.

Për këtë arsye kërkuam dhe njëherë konfirmim të kësaj shifre dhe nga ana e DPGJC ky deklarim u ndryshua **në 2,037,294 në total adresa të përditësuara nga të cilat 1,700,668 të realizuara në mënyrë automatike**, në informacionin e përcjellë më datë 18 Nëntor 2020.

Interesimit tonë për veprime të mëtejshme të realizuara për nga ana e DPGjC dhe shërbimit të gjendjes Civile për rregullimin e kësaj situate apo përditësimit të mëtejshëm të adresave, kjo e fundit më datë 18 Dhjetor 2020 na konfirmon se vetëm 1,719,647 shtetas kanë adresë të saktë në RKGjC. Kjo nënkupton ***se më pak se 40% e popullsisë ka një adresë të saktë***.

Ne kemi vazhduar ta monitorojmë këtë fenomen dhe më datë 8 Shkurt 2021DPGjC na konfirmon se vetëm 1,590,015 shtetas kanë adresë të saktë në RKGjC, sipas formatit të ri. Kjo nënkupton ***se 33% e popullsisë ka një adresë të saktë ne formatin e ri***.

Gjithashtu ky numër është 129,632 më i vogël se raportimi nga DPGjC më datë 08 Dhjetor 2020. ***Gjë që ri konfirmon raportimet jo të sakta dhe mospërputhje shifrash nga DPGjC***.

Me gjithë se kemi kërkuar në mënyrë të vazhdueshme nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga DPGjC mbi procedurat dhe aktet ligjore apo nën ligjore mbi të cilat është mbështetur realizimi i këtij procesi.

Rezulton se Ministria e Brendshme, në periudhën 2016-2017 ka investuar në projektin "Identifikimi dhe popullimi i adresës së shtetasve derë më dere. Ky projekt parashikonte identifikimin e adresës reale të shtetasve, sipas parashikimeve

ligjore, duke plotësuar të tetë elementët e adresës. Projekti është shtrirë në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe sipas DPGJC ka regjistruar 2.4 milion deklarime të shtetasve lidhur me adresat e tyre reale, afërsisht 53% të popullsisë.

Bazuar në deklarimet e DPGjC duke filluar nga Janar 2020, mbi bazë të këtij informacioni janë realizuar procedura automatike për të përditësuar në Regjistrin kombëtar te gjendjes civile, 8 fushat përbërësve të adresës për **1,700,668 shtetas.**

**Duhet theksuar se një përditësim/ndryshim i adresave në mënyrë kaq masive krijon problematika në lidhje saktësinë dhe integritetin e regjistrit kombëtar te gjendjes civile si dhe mund te impaktojë thellësisht ligjshmërinë e listës së zgjedhësve.**

Në pikëpamjen time, ky deklarim është shumë shqetësues dhe po i kushtohet një vëmendje të madhe, megjithëse DPGjC deklaron se gjatë këtij procesi **nuk janë ndryshuar/përditësuar elementët e përbërësve zgjedhor KODI i QV** të shtetasve dhe konfirmon se:

> ***"Gjatë procesit të saktësimit të adresës nga projekti "Popullimi" janë saktësuar vetëm 8 elementët e adresës: Bashkia, Njësia Administrative, Qytet/Fshati, Rruga, Ndërtesa, Hyrja, Apartamenti, Kodi Postar. Thekson se Zyra e Gjendjes Civile dhe përbërësit zgjedhorë të shtetasve nuk janë ndryshuar."***

Në disa testime të realizuara nuk na ka rezultuar ndryshim i QV apo elementëve të tjerë të cilët do të reflektonin ndryshime të listës së zgjedhësve por ndryshimet e kryera me ndërhyrje drejt për drejt ne regjistër kanë sjelle kaos tek shtetasit si dhe kane sjell një mospërputhje te adresave me kodet e vendbanimit.

Bazuar në Ligji Nr. 10 129, datë 11.5.2009 "PËR GJENDJEN CIVILE" i ndryshuar, sanksionohet qartë e drejta që kanë shtetasit për të zgjedhur adresën e vendbanimit.

Për të korrigjuar gabimet e kryera gjatë këtij procesi, bazuar në udhëzime të DPGjC-se, Zyrat e gjendjes civile kanë kontaktuar shtetasit e prekur nga ndryshimi i adresës duke i kërkuar të paraqiten personalisht pranë ZGjC-ve dhe me kërkesën e tij të shoqëruar me një fotokopje te certifikatës së pronësisë apo të kontratës së qirasë , shtetasi mund te riktheje adresën aty ku e ka pasur përpara se ti ndryshohej ne sistem.

Sipas udhëzimit te DPGjC-se, shtetasit e prekur nga ndryshimi i adresës duhet të paraqitet personalisht pranë ZGjC-ve dhe me kërkesën e tij të shoqëruar me një fotokopje te certifikatës së pronësisë apo të kontratës së qirasë , shtetasi mund te riktheje adresën aty ku e ka pasur përpara se ti ndryshohej ne sistem.

Por ky proces mund të ndodh vetëm në se shtetasi merr dijeni për ndryshimin qe i ka bërë sistemi i Gjendjes Civile pasi nuk ka një sistem te organizuar nga DPGjC se si do te njoftohen këta shtetas për tu paraqitur pranë zyrave te gjendjes civile.

Procesi që do të realizohet në vijim për rregullimin e adresave pas ndryshimit arbitrar të tyre do të jetë një proces i zakonshëm ndryshimi adresa vendbanimi nga shtetasit bazuar në vete deklarimi dhe dokumente shoqërues, sepse në kuptimin e ligjit për Gjendjen Civile termi **Korrigjim** në kuptohet vetëm korrigjimin material për emrin apo mbiemrit të shtetasit dhe jo te adresës së vendbanimit.

Përfundimisht si rezultat i këtij procesi **"Migrimi i të Dhënave në Sistem"**. Këta shtetas aktualisht kanë adrese të ndryshme regjistrimi ne kundërshtim ***germën (d) te nenit 44, te Kodit Zgjedhor i cili sanksionon qarte se "Zgjedhësi duhet të ketë vendbanimin e regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit"***. Aktualisht këta shtetas votojnë ne QV te ndryshme nga adresa e regjistrimit ne gjendjen civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, thekson se ka identifikuar të gjithë shtetasit të cilët kanë **adresë të pasaktë në RKGJC** dhe shtetasit të cilëve **njësia administrative e adresës nuk përputhet me zyrën e gjendjes civile të tyre.**

Nga analiza e të dhënave të informacionit nga DPGjC rezulton se **195,041** shtetas **Elementi i adresës së Njësisë Administrative është jashtë territorit administrativ të Zyrave të Gjendjes Civile**. Kjo shifër është pasojë e drejtë për drejtë e përditësimit automatik i elementëve të adresës. Për çdo bashki ky ndryshim pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

| Nr. | Qarku | Bashkia | Nr. I Shtetasve |
|---|---|---|---|
| 1 | Berat | Bashkia Berat | 3,335 |
| 2 | Berat | Bashkia Kuçovë | 2,574 |
| 3 | Berat | Bashkia Poliçan | 652 |
| 4 | Berat | Bashkia Skrapar | 1,575 |
| 5 | Berat | Bashkia Ura Vajgurore | 1,154 |
| 6 | Dibër | Bashkia Bulqizë | 2,150 |
| 7 | Dibër | Bashkia Dibër | 3,489 |
| 8 | Dibër | Bashkia Klos | 894 |
| 9 | Dibër | Bashkia Mat | 1,244 |
| 10 | Durrës | Bashkia Durrës | 10,819 |
| 11 | Durrës | Bashkia Krujë | 2,177 |
| 12 | Durrës | Bashkia Shijak | 1,511 |
| 13 | Elbasan | Bashkia Belsh | 1,518 |

| Nr. | Qarku | Bashkia | Nr. I Shtetasve |
|---|---|---|---|
| 14 | Elbasan | Bashkia Cërrik | 923 |
| 15 | Elbasan | Bashkia Elbasan | 10,854 |
| 16 | Elbasan | Bashkia Gramsh | 3,052 |
| 17 | Elbasan | Bashkia Librazhd | 2,148 |
| 18 | Elbasan | Bashkia Peqin | 3,233 |
| 19 | Elbasan | Bashkia Përrenjas | 1,053 |
| 20 | Fier | Bashkia Divjake | 879 |
| 21 | Fier | Bashkia Fier | 6,759 |
| 22 | Fier | Bashkia Lushnje | 2,004 |
| 23 | Fier | Bashkia Mallakastër | 3,115 |
| 24 | Fier | Bashkia Patos | 2,029 |
| 25 | Fier | Bashkia Roskovec | 1,244 |
| 26 | Gjirokastër | Bashkia Dropull | 139 |
| 27 | Gjirokastër | Bashkia Gjirokastër | 2,375 |
| 28 | Gjirokastër | Bashkia Këlcyre | 599 |
| 29 | Gjirokastër | Bashkia Libohove | 850 |
| 30 | Gjirokastër | Bashkia Memaliaj | 1,758 |
| 31 | Gjirokastër | Bashkia Përmet | 868 |
| 32 | Gjirokastër | Bashkia Tepelenë | 994 |
| 33 | Korçë | Bashkia Devoll | 1,234 |
| 34 | Korçë | Bashkia Kolonjë | 2,228 |
| 35 | Korçë | Bashkia Korçë | 4,294 |
| 36 | Korçë | Bashkia Maliq | 2,706 |
| 37 | Korçë | Bashkia Pogradec | 3,547 |
| 38 | Korçë | Bashkia Pustec | 121 |
| 39 | Kukës | Bashkia Has | 923 |
| 40 | Kukës | Bashkia Kukës | 5,369 |
| 41 | Kukës | Bashkia Tropojë | 1,451 |
| 42 | Lezhe | Bashkia Kurbin | 2,006 |
| 43 | Lezhe | Bashkia Lezhë | 4,453 |
| 44 | Lezhe | Bashkia Mirditë | 2,554 |
| 45 | Shkodër | Bashkia Fushë - Arrëz | 1,112 |
| 46 | Shkodër | Bashkia Malësi e Madhe | 4,245 |
| 47 | Shkodër | Bashkia Pukë | 1,582 |
| 48 | Shkodër | Bashkia Shkodër | 6,540 |
| 49 | Shkodër | Bashkia Vau i Dejës | 2,687 |

| Nr. | Qarku | Bashkia | Nr. I Shtetasve |
|---|---|---|---|
| 50 | Tirane | Bashkia Kamzë | 2,492 |
| 51 | Tirane | Bashkia Kavajë | 2,921 |
| 52 | Tirane | Bashkia Rrogozhinë | 1,703 |
| 53 | Tirane | Bashkia Tiranë | 50,719 |
| 54 | Tirane | Bashkia Vorë | 1,533 |
| 55 | Vlore | Bashkia Delvinë | 449 |
| 56 | Vlore | Bashkia Finiq | 546 |
| 57 | Vlore | Bashkia Himarë | 893 |
| 58 | Vlore | Bashkia Konispol | 215 |
| 59 | Vlore | Bashkia Sarandë | 1,047 |
| 60 | Vlore | Bashkia Selenicë | 2,991 |
| 61 | Vlore | Bashkia Vlorë | 4,512 |
| | | **Total** | **195,041** |

Në nivel Qarku ky ndryshim është:

| Nr. | Qarku | Popullsia | Shtetas me QV jashtë ZGJC | % |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Berat | 229,291 | 9,290 | 4.05% |
| 2 | Dibër | 173,846 | 7,777 | 4.47% |
| 3 | Durrës | 461,786 | 14,507 | 3.14% |
| 4 | Elbasan | 448,002 | 22,781 | 5.09% |
| 5 | Fier | 509,428 | 16,030 | 3.15% |
| 6 | Gjirokastër | 147,765 | 7,583 | 5.13% |
| 7 | Korçë | 349,749 | 14,130 | 4.04% |
| 8 | Kukës | 110,127 | 7,743 | 7.03% |
| 9 | Lezhë | 224,994 | 9,013 | 4.01% |
| 10 | Shkodër | 344,477 | 16,166 | 4.69% |
| 11 | Tiranë | 1,157,144 | 59,368 | 5.13% |
| 12 | Vlorë | 388,068 | 10,653 | 2.75% |
| **Total** | | **4,544,677** | **195,041** | **4.29%** |

**Praktikisht nga analiza e kryer na rezulton se për një pjesë të Shtetasve të cilët dispon474onin më shumë së një pronë të paluajtshme të deklaruar ju është ndryshuar adresa e banimit duke i transferuar në adresat e pasurive të tjera te paluajtshme pa u verifikuar më parë në se kjo është vërtetë adresa e vendbanimit dhe pa e krahasuar me atë me adresën ekzistuese.**

Janë konstatuar nga ana jonë raste kur shtetas të njëjtës familje janë regjistruar në adresa të ndryshme banimi, dhe në disa raste përveç adresave të ndryshme njëra prej adresave nuk ka asnjë lidhje pronësie me shtetasin të cilit i është ndryshuar adresa.

Me gjithë se kemi kërkuar në mënyrë të vazhdueshme nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga DPGjC mbi procedurat dhe aktet ligjore apo nën ligjore mbi të cilat është mbështetur realizimi i këtij procesi. Na është thënë në mënyrë verbale se ka një urdhër të Ministrit të Brendshëm, por nuk na është vënë kurrë në dispozicion.

**Bazuar në këto të dhëna konkludojmë se i gjithë ky proces i pasqyruar më sipër shoqërohet me mungesë të plotë të ligjshmërisë. Nuk ka akt ligjor apo nënligjor që të normojnë të gjithë këtë proces të kryer deri më tani nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.**

## 6.4. Ndryshimi i QV

Bazuar në Kodin Zgjedhor dhe vendimet në zbatim të tij ndryshimi i QV ndodh nga shërbimi i Gjendjes Civile në rastet kur ndryshon adresa ose me vendim të kryetarit të Bashkisë mbas një kërkese me shkrim nga ana e qytetarit.

Sipas kontrolleve dhe krahasimeve të kryera nga grupi i auditimit në vija të përgjithshme na rezulton se kemi ndryshimet e më poshtme të QV.

| Nr. | Krahasimi | Nr. I Shtetasve që kanë ndryshuar QV |
|---|---|---|
| 1 | Ndryshimi nga Lista 2019 në Ek_1 | 92,642 |
| 2 | Ndryshimi nga Ek_1 në Ek_2 | 42,804 |
| 3 | Ndryshimi nga Ek_2 në Ek_3 | 14,374 |
| 4 | Ndryshimi nga Ek_3 në Ek_4 | 13,358 |
| 5 | Ndryshimi nga Ek_4 në Ek_5 | 12,440 |
| 6 | Ndryshimi nga Ek_5 në Ek_6 | 9,711 |
| 7 | Ndryshimi nga Ek_6 në LP | 6,024 |
| | Total nga Ek_1 në LP | 98,711 |

Sipas një krahasimi të bërë ne rang qarku nga Ek_1 në LP rezulton se kanë ndryshuar brenda dhe jashtë bashkisë 98,711 Zgjedhës. Në tabelën e mëposhtme jepen shifrat në bazë qarku:

| QARKU | Ndryshon Bashki | Brenda Bashkisë | Total |
|---|---|---|---|
| Berat | 824 | 3,814 | 4,638 |
| Dibër | 557 | 5,705 | 6,262 |
| Durrës | 2,827 | 4,576 | 7,403 |
| Elbasan | 1,195 | 11,667 | 12,862 |
| Fier | 2,200 | 4,473 | 6,673 |
| Gjirokastër | 465 | 5,421 | 5,886 |
| Korçë | 990 | 5,876 | 6,866 |
| Kukës | 335 | 7,093 | 7,428 |
| Lezhe | 965 | 5,309 | 6,274 |
| Shkodër | 1,326 | 3,421 | 4,747 |
| Tirane | 8,234 | 16,526 | 24,760 |
| Vlorë | 1,310 | 3,602 | 4,912 |
| Total | 21,228 | 77,483 | 98,711 |

Vlen për të theksuar se 54,242 zgjedhës kanë ndryshuar QV si rezultat i shkrirjes apo bashkimit të QV-ve.

DPGjC interesimit tonë, më datë 08.02.2021 na konfirmon se 163,185 zgjedhës kanë QV të ndryshme nga Njësia Administrative ku banojnë. (tabela bashkangjitur - delta_votues_me_qv_te_ndryshme_2017_2019_2021)

**Duam të theksojmë se për eliminimin e problemeve që vijnë nga ndryshimi i QV duhet të realizohej njoftimi me shkrim i zgjedhësve sipas detyrimeve ligjore, nga ana e Kryetarëve të Bashkive respektive. Në dijeninë tonë ky proces nuk është realizuar në asnjë Bashki.**

Nga ana e DPGjC na është konfirmuar vënia në dispozicion e informacionit dhe buxhetit të nevojshëm për këtë proces.

### 6.5. 7 Regjistrimi i Votuesve me vendbanim jashtë vendit

Bazuar në kriterin bazë që të drejtë të votojnë pranë vendbanimeve të tyre zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë vetëm ata zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile me adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit.

Bazuar në VKM Nr. 915, datë 4.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave për njoftimin e detyrimit për vetë deklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të republikës së Shqipërisë, të procedurës së plotësimit e të dorëzimit të formularit të vetë deklarimit dhe të dokumenteve shoqëruese të tij, administrimin e tyre nga autoritetet përgjegjëse, si dhe të shërbimeve të tjera që ofrojnë këto autoritete ndaj shtetasve" aplikimet e shtetasve të kësaj kategorie kryen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania.

Audituesi Teknik i është drejtuar DPGjC-së për informacion në lidhje me rezultatet për këtë proces. DPGJC në email të datës 08.01.2021 na informon se deri më këtë datë nëpërmjet portalit "e-Albania" janë kryer 2,337 aplikime, nga të cilat DPGjC nuk ka procesuar asnjë prej tyre. Gjithashtu DPGjC deklaron se ndër vite kanë të regjistruar në RKGjC 921 shtetas me vendbanim jashtë vendit.

Në vijim, më datë 20 shkurt 2021 DPGjC na informon paraprakisht se deri në këtë datë në RKGjC janë të regjistruara adresa jashtë vendit për 4,572 shtetas ose 3,613 Zgjedhës, prej të cilëve 2,774 kanë kryer deklarimin dhe përditësimin në vitin 2021.

Këta janë të shpërndarë sipas qarqeve si më poshtë:

| Nr. | Qarku | Regjistrime |
|---|---|---|
| 1 | Berat | 131 |
| 2 | Diber | 143 |
| 3 | Durres | 124 |
| 4 | Elbasan | 416 |
| 5 | Fier | 688 |
| 6 | Gjirokaster | 90 |
| 7 | Korce | 368 |
| 8 | Kukes | 65 |
| 9 | Lezhe | 184 |
| 10 | Shkoder | 191 |
| 11 | Tirane | 894 |
| 12 | Vlore | 319 |
| **TOTALI** | | **3,613** |

## 7. Opinion

a) Problematika kryesore e evidentuar ka te beje me ndryshimin e adresave te shtetasve dhe nga verifikimet e kryera konkludojmë se i gjithë procesi për ndryshmin e adresave te shtetasve është bere ne mungesë të plotë të ligjshmërisë sepse nuk ka asnjë akt ligjor apo nënligjor që të normojnë të gjithë procesin e kryer deri më tani nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Ky proces ka sjelle kaos dhe pasiguri tek shtetasit dhe duhen ndërmarrë sa me pare iniciativat e nevojshme për te rikthyer ne adresat e ligjshme shtetasit te cilëve adresa i është ndryshuar ne një zone qe nuk mbulohet nga zyra e GJC ne te cilën ka qene i regjistruar.

b) Njoftimi me shkrim i zgjedhësve (Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.7.2012, shfuqizuar fjalia e fundit e pikës 1 dhe shtuar pika 6 me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020)

Gjithashtu është U konstatua nga Auditimi/kontrolli në terren se nuk janë zbatuar detyrimet që rrjedhin nga Neni 52 i Kodit Zgjedhor, nuk janë bërë njoftimet ***"brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë të zgjedhësve, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të nenit 51, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore kryen lajmërimin me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore".***

c) Bazuar në evidentime dhe verifikime të kryera në teren rezulton se në Listën Përfundimtare vazhdojnë të ekzistojnë persona të cilët kanë ndërruar jetë.

d) Auditi nga burime të tjera dhe duke analizuar extraktet e gjeneruara deri më tani ka konstatuar (si p.sh. në Qarkun Kukës QV 0593 është shkrirë në QV 0598 ndërkohë kur ajo është më afër në distancë me QV 0595) se disa QV janë bashkuar me QV të tjerë të cilat kanë vend ndodhjen shume larg, ndërkohë që mund te bashkoheshin me QV të cilat janë me vendndodhje të afërta. Interesimin tonë më datë 19 Shkurt 2021 nuk iështë dhënë përgjigje akoma nga DPGjC.

## 8. Shtojca

Bashkangjitur korrespondenca me DPGjC

1. email 02.11.2020
2. email.05.11.2020
3. email 12.11.2020
4. email 18.11.2020
5. email 20.11.2020
6. email 23.11.2020
7. email 24.11.2020
8. email 04.12.2020
9. email 15.12.2020
10. email 18.12.2020
11. email 21.12.2020
12. email 05.01.2021
13. email 11.01.2021
14. email 13.01.2021
15. email 20.02.2021
16. email 03.02.2021
17. email 05.03.2021

Gmail Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>

---

**Statistikat dhe numri i ndryshimeve të adresave**

---

**Vangjush Stavro** <Vangjush.Stavro@mb.gov.al> Mon, Nov 2, 2020 at 4:30 PM
To: "l.kercuku@gmail.com" <l.kercuku@gmail.com>
Cc: Bledar Doracaj <Bledar.Doracaj@mb.gov.al>, Shpetim Cokaj <Shpetim.Cokaj@mb.gov.al>

Përshëndetje Z. Kërçuku,

Bashkëngjitur do të gjeni statistikat e ekstratit të dytë të gjeneruar dje, më 01 Nëntor 2020.
Gjithashtu, sipas kërkesës suaj më lejoni të njoftoj se nga data 01 Janar 2020, 1.806.131 adresa janë ndryshuar në regjistër nga punonjësit e zyrës së gjendjes civile, me kërkesë të shtetasit, ndërsa, 1.380.205 janë ndryshuar nga migrimi i të dhënave.

Punë të mbarë,

--
Vangjush Stavro, MEng

Drejtor i Sistemeve Informatike / Director of Information Systems
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile / General Directorate of Civil Status
Ministria e Brendshme / Ministry of Interior

Sheshi Skënderbej, Nr.3, 1001, Tirana, ALBANIA

---

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar,është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse , përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

---

Statistika.xlsx
10K

Gmail

Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>

# Kekesa nga Auditi

4 messages

**Roland Kercuku** <l.kercuku@gmail.com>
To: Vangjush Stavro <Vangjush.Stavro@mb.gov.al>
Cc: Shpetim.Cokaj@mb.gov.al, bledar.doracaj@mb.gov.al, lealba.pelinku@cec.gov.al

Tue, Nov 3, 2020 at 1:35 PM

Pershendetje,

Ne vijim te kryerjes se detyrave ngarkuar nga Kodi Zgjedhor, si grup Auditimi jemi ne pritje te marrjes se pergjigjeve te disa pyetjeve te parashtruara verbalisht gjate takimit prane DPGJC dhe ne emailin.

Me poshte po ju rendisim kerkesat tona:

1. Nisur nga emaili juaj i dates 02.11.2020 "*Gjithashtu, sipas kërkesës suaj më lejoni të njoftoj se nga data 01 Janar 2020, 1.806.131 adresa janë ndryshuar në regjistër nga punonjësit e zyrës së gjendjes civile, me kërkesë të shtetasit, ndërsa, 1.380.205 janë ndryshuar nga migrimi i të dhënave*",
   - Na beni me dije se mbi c'baze ligjore jeni mbeshtetur per te bere ndryshimet e adresave ne RKGJC?
   - Cila eshte procedura e ndjekur nga DPGJC per ndryshimet e adresave, me kerkese te shtetasve dhe nga "***migrimi***" i te dhenave?
   - Na vini ne dispozicion listen e shtetasve te cilet jane prekur nga ndryshimet e adresave te bera nga "***migrimi***" i te dhenave?
   - Na vini ne dispozicion listen e shtetasve te cilet kane ndryshuar adresen me kerkesen e tyre?
   - Ju lutemi te na sqaroni termin ***Migrim i te dhenave?***

2. Cila eshte procedura qe po ndiqet per sistemimin e ndryshimeve te adresave nga "***migrimi***" i te dhenave ne RKGJC?
   - Keto ndyshime per sistemimin e adresave si po behen, ne menyre automatike per rikthimin ne adresen e meparshme apo me kerkese te vete qytetarit? Nese ndryshimi do te behet me kerkese te qytetarit cfare dokumentacioni do tju kerkohet dhe cilat jane kostot administrative (monetare) per te bere kete ndyshim.

3. Percaktimi i nje posti pune prane ambjenteve te Drejtorise se Pergjithshme te Gjendjes Civile. Prej 7 ditesh nga takimi i pare prane DPGJC-se ende nuk kemi nje post pune te caktuar per te ushtruar veprimtarine e auditimit sipas percaktimeve ne Kodin Zgjedhor.

4. Kerkojme te na vihen ne dispozicion Dublimet e ekstrakteve dhe ndyshimet ndermejt tyre.

5. Te na vihet ne dispozicion lista e zgjedhesve qe kane bere ndryshim nga nje qender votimi ne nje tjeter nga viti 2019 e deri me sot?

6. Te na vihet ne dispozicion Pasqyrimi i Dekreteve te Presisdentit te Republikes per marrjen ose lenien e shtetesise Shqiptare ne Rregjistrin e Gjendjes Civile.
   - Listen e sakte te shtetasve dhe shperndarjen e tyre.

7. Numri i pergjithshem i popullsise ne Republiken e Shqiperise.
   - Numri i popullsise per cdo Qark te Republikes se Shqiperise deri me daten e sotme;
   - Ndryshimet e numrit te popullsise nga Qarku ne Qark per cdo muaj nga viti 2017 e deri me sot.

8. Ne piken 6 te Udhezimit nr. 6314 Prot. Date 10.09.2020, citohet: *Per qendrat e votimit me me pak se 200 (dyqind) zgjedhes....* Pika 6 e ketij udhezimi bie ndesh me parashikimet ne Kodin te ri Zgjedhor, nenet 46 dhe 62, ku percaktohet se ky numer duhet te jete *per qendrat e votimit me me pak se 300 (treqind) zgjedhes*. Verbalisht na informuat se eshte bere korrigjimi i Udhezimit, lutemi te na vendosni ne dispozicion aktin zyrtar te korrigjimit dhe nese ky akt Ju eshte komunikuar dhe kur eshte bere, Bashkive dhe zyrave vendore te gjendjes civile.

9. Procedure qe detajon hapat qe ndiqen per identifikimin e zonave ka një numër zgjedhësish më të vogël se 300 zgjedhës dhe kur numri i zgjedhësve të një zone qendre votimi është më i madh se 1,000. Si zbatohet ky proces ne praktike. Si behet identifikimi dhe bllokimi i tyre?

10. Cila eshte procedura qe percakton hapat qe ndiqen per identifikimin dhe perjashtimin nga lista e zgjedhesve te shtetasve që kanë mbushur 100 vjeç sipas percaktimit te nenit 51 te kodit zgjedhor. Si kryhet ky proces ne praktike, identifikohen nga Zyrat e gjendjes civile dhe bejne ndryshime ne sistem, dergohen lista prane jush dhe ju krijoni file qe i permban te gjithe keta shtetas apo behet filtrime nga juaj ne sistem. Si gjurmohen ne sistem keto veprime?

- A ka procedure qe detajon hapat qe ndiqen per ne listen e zgjedhesve te shtetasve që kanë mbushur 100 vjeç sipas percaktimit te nenit 53 te kodit zgjedhor. Si kryhet ky proces ne praktike, identifikohen nga Zyrat e gjendjes civile dhe bejne ndryshime ne sistem, dergohen lista prane jush dhe ju krijoni file qe i permban te gjithe keta shtetas apo behet filtrime nga juaj ne sistem. Si gjurmohen ne sistem keto veprime ?

11. Kerkojme te na vihet ne dispozicion harten me ndarje ne Zones se Qendrave te Votimit.

Me Respekt

**Auditi Teknicien**
Roland Kërçuku

---

**Vangjush Stavro** <Vangjush.Stavro@mb.gov.al> Thu, Nov 5, 2020 at 4:44 PM
To: Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>
Cc: Shpetim Cokaj <Shpetim.Cokaj@mb.gov.al>, Bledar Doracaj <Bledar.Doracaj@mb.gov.al>, Lealba Pelinku <Lealba.Pelinku@cec.gov.al>

Përshëndetje Z. Kërçuku,

Më poshtë do të gjeni përgjigjet për kërkesat që na keni drejtuar:

1. Nisur nga emaili juaj i dates 02.11.2020 "Gjithashtu, sipas kërkesës suaj më lejoni të njoftoj se nga data 01 Janar 2020, 1.806.131 adresa janë ndryshuar në regjistër nga punonjësit e zyrës së gjendjes civile, me kërkesë të shtetasit, ndërsa, 1.380.205 janë ndryshuar nga migrimi i të dhënave",
Në zbatim të ligjit 10129 për Gjendjen Civile, i ndryshuar, çdo shtetas ka detyrimin që brenda 30 ditëve nga ndryshimi i vendbanimit të paraqitet pranë zyrës së gjendjes civile përkatëse dhe të përditësojë vendbanimin e tij të ri.
Në këtë kuadër, Ministria e Brendshme, duke parë prirjen e shtetasve, për mosdeklarimin real të adresës sipas parashikimeve ligjore investoi në projektin "Identifikimi dhe popullimi i adresës së shtetasve derë më derë".
Ky projekt parashikonte identifikimin e adresës reale të shtetasve, sipas parashikimeve ligjore, duke plotësuar të tetë elementët e adresës, në zbatim të udhëzimit të ministrit të brendshëm, për elementët e adresës dhe modelin e saj.

Projekti u shtri në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe u regjistruan 2.4 milion deklarime të shtetasve lidhur me adresat e tyre reale.

Në zbatim të udhëzimit të ministrit për elementët e adresave dhe modelin e saj, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, vijoi me procesin e saktësimit e adresës së shtetasve sipas deklarimeve të tyre.
Theksojmë se realizimi i këtij procesi, u krye pa prekur elementët përbërës të kodit zgjedhor të shtetasve.

Termi "migrimi i të dhënave" i përdorur nga ne në kontekstin teknik, nënkupton, saktësim të dhënave sipas procesit të sqaruar më sipër.

**2. Cila eshte procedura që po ndiqet per sistemimin e ndryshimeve te adresave nga "migrimi" i te dhenave ne RKGJC? Keto ndyshime per sistemimin e adresave si po behen, ne menyre automatike per rikthimin ne adresen e**

meparshme apo me kerkese te vete qytetarit? Nese ndryshimi do te behet me kerkese te qytetarit cfare dokumentacioni do tju kerkohet dhe cilat jane kostot administrative (monetare) per te bere kete ndyshim.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka identifikuar të gjithë shtetasit të cilët kanë **adresë të pasaktë në RKGJC** dhe shtetasit të cilëve **njësia administrative e adresës nuk përputhet me zyrën e gjendjes civile të tyre.**

Kjo është listë është vendosur në dispozicion zyrave të gjendjes civile, e shoqëruar me kërkesës zyrtare nga Ministria e Brendshme, për të vijuar me njoftimin e shtetasve nëpërmjet telefonit, për të kryer saktësimin e adresës pranë zyrës së gjendjes civile.

Pjesë e këtij procesi do të jetë vënia në dispozicion e një kopje të një dokumenti i cili dikton adresën e tyre, qoftë certifikatë pronësie apo kontratë qeraje, punonjësit të zyrës së gjendjes civile, i cili menjëherë, vijon me saktësimin e adresës.

Në të mirë të kësaj nisme, është hequr dhe gjoba prej 10.000 Lekë, që ka qenë e parashikuar në ligjin e gjendjes civile, për vonesë deklarimi të vendbanimit të ri.

Kosto e këtij procesi, 0 Lekë.

Për më tepër, në mes të muajit Nëntor 2020, pritet të përfundojë dhe shërbimi online në e-Albania, i saktësimit të vendbanimit, nëpërmjet të cilit shtetasit mund të dërgojnë adresën e tyre të saktë dhe dokumentacionin shoqërues për të shmangur radhat në zyrat e gjendjes civile.

3. Percaktimi i nje posti pune prane ambjenteve te Drejtorise se Pergjithshme te Gjendjes Civile. Prej 7 ditesh nga takimi i pare prane DPGJC-se ende nuk kemi nje post pune te caktuar per te ushtruar veprimtarine e auditimit sipas percaktimeve ne Kodin Zgjedhor.

Jemi duke ndjekur këtë proces. Me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm, duke ju referuar masave anticovid, po përpilojmë një plan prezence në punë tek i cili do të përfshiheni dhe ju.

4. Kerkojme te na vihen ne dispozicion Dublimet e ekstrakteve dhe ndyshimet ndermejt tyre.

Aktualisht disponojmë këtë informacion lidhur me dublimet e shtetasve që plotësojnë kushtet për të votuar:

Dublime të dyshuara brenda ZGJC 811

Dublime të dyshuara jashtë ZGJC 135

5. Te na vihet ne dispozicion lista e zgjedhesve qe kane bere ndryshim nga nje qender votimi ne nje tjeter nga viti 2019 e deri me sot?

Aktualisht disponojmë këtë informacion:

140.971 - shtetas me përbërës zgjedhor të ndryshuar

Po punohet që të vendoset në dispozicion një informacion më i detajuar.

6. Te na vihet ne dispozicion Pasqyrimi i Dekreteve te Presisdentit te Republikes per marrjen ose lenien e shtetesise Shqiptare ne Rregjistrin e Gjendjes Civile. Listen e sakte te shtetasve dhe shperndarjen e tyre.

Në lidhje me këtë kërkesë, luteni të drejtoheni institucionit të presidentit. Zyrat e gjendjes civile mund të disponojnë informacion lidhur me dekretin e presidentit por që mund të mos jenë zbardhur sepse shtetasit nuk janë paraqitur pranë zyrave për të përfunduar procesin.

7. Numri i pergjithshem i popullsise ne Republiken e Shqiperise. Numri i popullsise per cdo Qark te Republikes se Shqiperise deri me daten e sotme; Ndryshimet e numrit te popullsise nga Qarku ne Qark per cdo muaj nga viti 2017 e deri me sot.

Dokumenti gjendet bashkëngjitur (Popullsia - Qarqe.xlsx).

8. Ne piken 6 te Udhezimit nr. 6314 Prot. Date 10.09.2020, citohet: *Per qendrat e votimit me me pak se 200 (dyqind) zgjedhes....* Pika 6 e ketij udhezimi bie ndesh me parashikimet ne Kodin te ri Zgjedhor, nenet 46 dhe 62, ku percaktohet se ky numer duhet te jete *per qendrat e votimit me me pak se 300 (treqind) zgjedhes*. Verbalisht na informuat se eshte bere korrigjimi i Udhezimit, lutemi te na vendosni ne dispozicion aktin zyrtar te korrigjimit dhe nese ky akt Ju eshte komunikuar dhe kur eshte bere, Bashkive dhe zyrave vendore te gjendjes civile.

Dokumenti gjendet bashkëngjitur (FZ-2020-165.pdf).

9. Procedure qe detajon hapat qe ndiqen per identifikimin e zonave ka një numër zgjedhësish më të vogël se 300 zgjedhës dhe kur numri i zgjedhësve të një zone qendre votimi është më i madh se 1,000. Si zbatohet ky proces ne praktike. Si behet identifikimi dhe bllokimi i tyre?

Çdo ditë, zyrat e gjendjes civile njihen me statistikat lidhur me gjendjen e qendrave të tyre të votimit. Sipas rastit ato dërgojnë pranë kryetarit të bashkisë kërkesës për vendim për ndarje apo bashkim të qendrave të votimit me daljen e vendimit të kryetarit të bashkisë, zyrat e gjendjes civile vijojnë me zbatimin e këtij vendimi.

10. Cila eshte procedura qe percakton hapat qe ndiqen per identifikimin dhe perjashtimin nga lista e zgjedhesve te shtetasve që kanë mbushur 100 vjeç sipas percaktimit te nenit 51 te kodit zgjedhor. Si kryhet ky proces ne praktike, identifikohen nga Zyrat e gjendjes civile dhe bejne ndryshime ne sistem, dergohen lista prane jush dhe ju krijoni file qe i permban te gjithe keta shtetas apo behet filtrime nga juaj ne sistem. Si gjurmohen ne sistem keto veprime? A ka

procedure qe detajon hapat qe ndiqen per ne listen e zgjedhesve te shtetasve që kanë mbushur 100 vjeç sipas percaktimit te nenit 53 te kodit zgjedhor. Si kryhet ky proces ne praktike, identifikohen nga Zyrat e gjendjes civile dhe bejne ndryshime ne sistem, dergohen lista prane jush dhe ju krijoni file qe i permban te gjithe keta shtetas apo behet filtrime nga juaj ne sistem. Si gjurmohen ne sistem keto veprime ?
Me dekretimin e datës së zgjedhjeve Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në zbatim të kodit zgjedhor, identifikon shtetasit 100 vjeç e sipër. Këta shtetas, shfaqen në rubrikën raporte të RKGJC, te çdo zyrë e gjendjes civile përkatëse.
Në vijim zyrat e gjendjes civile, në zbatim të udhëzimit të Ministrit për zgjedhjet, procedojnë me identifikimin dhe njoftimin e shtetasve nëpërmjet kryepleqve dhe ndërlidhësve me komunitetin për të bërë të mundur sensibilizimin e kësaj kategorie për të plotësuar formularin që parashikohet në udhëzim me qëllim përfshirjen e tyre në listën zgjedhore duke ndryshuar kodin e qendrës së votimit nga 8899 në kodin respektiv të të qendrës së votimit ku duhet të votojë.

11. Kerkojme te na vihet ne dispozicion harten me ndarje ne Zones se Qendrave te Votimit.
Ky informacion nuk administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Për informacion më të detajuar luteni të drejtoheni bashkive, pasi sipas parashikimeve të kodit zgjedhor ato bëjnë përditësimin dhe raportimin pranë KQZ.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe kontributin tuaj në këtë proces,

---

**Vangjush Stavro, MEng**

Drejtoria e Sistemeve Informatike / Directory of Information Systems
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile / General Directorate of Civil Status
Ministria e Brendshme / Ministry of Interior

Sheshi Skenderbej, Nr.3, 1001
Tirana, ALBANIA

---

**From:** Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>
**Sent:** 03 November 2020 13:35
**To:** Vangjush Stavro
**Cc:** Shpetim Cokaj; Bledar Doracaj; Lealba Pelinku
**Subject:** Kekesa nga Auditi

[Quoted text hidden]

---

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar,është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse , përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

---

**2 attachments**

**Popullsia - Qarqe.xlsx**
13K

**FZ-2020-165.pdf**
841K

---

**/angjush Stavro** <Vangjush.Stavro@mb.gov.al> Thu, Nov 5, 2020 at 4:46 PM
'o: Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>
:c: Shpetim Cokaj <Shpetim.Cokaj@mb.gov.al>, Bledar Doracaj <Bledar.Doracaj@mb.gov.al>, Lealba Pelinku
:Lealba.Pelinku@cec.gov.al>

Ju lutem referohuni këtij dokumenti bashkëngjitur për pikën 8.

Faleminderit,

---

**Vangjush Stavro, MEng**

Drejtoria e Sistemeve Informatike / Directory of Information Systems
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile / General Directorate of Civil Status
Ministria e Brendshme / Ministry of Interior

Sheshi Skenderbej, Nr.3, 1001
Tirana, ALBANIA

---

**From:** Vangjush Stavro
**Sent:** 05 November 2020 16:44
**To:** Roland Kercuku
**Cc:** Shpetim Cokaj; Bledar Doracaj; Lealba Pelinku
**Subject:** Re: Kekesa nga Auditi

[Quoted text hidden]
[Quoted text hidden]

---

FZ-2020-171.pdf
1294K

---

**Vangjush Stavro** <Vangjush.Stavro@mb.gov.al> Fri, Nov 6, 2020 at 9:02 AM
To: Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>
Cc: Shpetim Cokaj <Shpetim.Cokaj@mb.gov.al>, Bledar Doracaj <Bledar.Doracaj@mb.gov.al>, Lealba Pelinku <Lealba.Pelinku@cec.gov.al>

Përshëndetje Z. Kërçuku,

Bashkëngjitur do të gjeni popullsinë sipas qarqeve për çdo muaj për vitet 2017 - 2020.
Ky informacion plotëson pikën 7.

Punë të mbarë,

---

**Vangjush Stavro, MEng**

Drejtoria e Sistemeve Informatike / Directory of Information Systems
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile / General Directorate of Civil Status
Ministria e Brendshme / Ministry of Interior

Sheshi Skenderbej, Nr.3, 1001
Tirana, ALBANIA

---

**From:** Vangjush Stavro
**Sent:** 05 November 2020 16:46
[Quoted text hidden]

[Quoted text hidden]
[Quoted text hidden]

---

**Popullsia sipas qarqeve, 2017-2020.xlsx**
15K

Gmail

Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>

# kerkesa Audit

3 messages

**Roland Kercuku** <l.kercuku@gmail.com> Mon, Nov 9, 2020 at 11:57 AM
To: Vangjush Stavro <Vangjush.Stavro@mb.gov.al>
Cc: bledar.doracaj@mb.gov.al, Shpetim.Cokaj@mb.gov.al, lealba.pelinku@cec.gov.al

Përshëndetje Z. Stavro,

Në vijim të e-mail-it tuaj datë 5 nëntor 2020, do të ju kërkoja të na saktësonit disa aspekte të punës së kryer nga DPGJC si edhe të na vihen në dispozicion disa materiale si me poshtë:

1. Në cilin afat kohor është zhvilluar projekti "Identifikimi dhe popullimi i adresës së shtetasve derë më derë", dhe si është siguruar përditësimi është këtyre deri në ditën e migrimit të 1,380,205 shtetasve.

2. Ju deklaroni se mbi 1.8 milion adresa janë ndryshuar me kërkesë të shtetasve? Duke u bazuar në një përllogaritje të vogël rezulton se mbi 15.000 shtetas kanë vizituar zyrat e gjendjes civile çdo ditë (duke përjashtuar 4 muaj e mbylljes për shkak të pandemisë). Ju lutem na vini ne dispozicion numrin e veprimeve të kryera nga çdo zyre e GJC për çdo muaj në lidhje me saktësimin e adresave me kërkesë të shtetasve.

3. Ju lutem na saktësoni se çfarë procedurash keni ndjekur gjatë përditësimit (migrimit) të adresave të 1.38 milion shtetasve për:

   a. Tu siguruar që këta shtetas nuk kishin kryer asnjë deklarim të adresës (pra nuk përfshiheshin në 1,8 milion rastet e sipërpërmendura.

   b. Gjatë procesit të saktësimit të adresës cilat fusha apo elementë të tjerë të gjendjes civile të shtetasve janë përditësuar.

   c. Ju lutem na saktësoni se gjatë përditësimit të mbi 3.18 milion adresave a është përditësuar kodi i vendbanimit, në se po mbi bazë të çfarë informacioni në se jo përse?

   d. Ju lutem na vini në dispozicion lidhjen që ekziston ndërmjet elementëve të adresës së vendbanimit dhe kodit të vendbanimit.

4. Në e-mail të datës 05/11/2020 ju theksoni se "realizimi i këtij procesi, u krye pa prekur elementët përbërës të kodit zgjedhor të shtetasve", por me ndryshimin/përditësimin e adresës së vend banimit, detyrimisht duhet të ndryshojë dhe kodi i vend banimit që është përbërës zgjedhor. Ju lutem na saktësoni.

5. Në e-mail të datës 05/11/2020 ju theksoni se "Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka identifikuar të gjithë shtetasit të cilët kanë adresë të pasaktë në RKGJC dhe shtetasit të cilëve njësia administrative e adresës nuk përputhet me zyrën e gjendjes civile të tyre", A mund të na vihet në dispozicion kjo listë ose minimalisht numrat e këtyre rasteve për çdo Qark/Bashki/ZGjC)?

6. Në e-mail të datës 05/11/2020 ju theksoni se ke filluar një proces ri-saktësimi dhe që korrigjimi i gabimeve/pasaktësive nuk ka kosto për qytetarët, ndërkohe që nuk ka asnjë akt ligjor që shmang pagesën e penalitetit nga ana e qytetarëve.

7. Në kërkesën e datës e 03/11/2020 në lidhje me pasqyrimin e Dekreteve të Presidentit të Republikës për marrjen ose lënien e shtetësisë Shqiptare, Ju jeni përgjigjur se jo të gjitha dekretet janë pasqyruar. Në këto kushte po e përsërisim pyetjen në formën e më poshtme:

a. A ekziston mundësia që shtetas Shqiptarë të mos jenë regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) dhe si pasojë të mos jenë pjesë e listës së votuesve, pra të ju mohohet e drejta e votës?

b. A ekziston mundësia që shtetas Shqiptarë të cilët kanë lënë shtetësinë të jenë akoma edhe shtetas Shqiptar në RKGjC, dhe si pasojë të kenë të drejtë votimi?

Në se ndonjë nga këto raste ekziston, atëherë ju lutem na jepni statistika.

8. Ju lutem a mund të na vini në dispozicion numrin e lindjeve dhe të vdekjeve për çdo Qark sipas çdo muaji të vitit duke filluar nga Janar 2017 e deri me sot.

Gjithashtu jemi në pritje të:

1. Vënies në dispozicion të një posti pune pranë ambienteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, për të ushtruar veprimtarinë e auditimit sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor.

2. Të një informacion më të detajuar për zgjedhësit që kanë ndryshim të QV nga viti 2019 (sipas jush "140.971 - shtetas rezultojnë me përbërës zgjedhor të ndryshuar"
3. A ka ndonjë informacion në lidhje me përditësime/ndryshime të QV si rezultat i shkrirjes së QV me më pak se 300 zgjedhës? Në rast se po ju lutem listën emërore të zgjedhësve të QV të shkrira së bashku me QV ku janë zhvendosur.

Ju uroj nje dite te mbare.

Me Respekt
**Auditi Teknicien**
Roland Kercuku

---

Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com> Thu, Nov 12, 2020 at 2:45 PM
To: Vangjush Stavro <Vangjush.Stavro@mb.gov.al>
Cc: Shpetim.Cokaj@mb.gov.al, bledar.doracaj@mb.gov.al, lealba.pelinku@cec.gov.al

Pershendetje z. Stavro,

1. Vazhdojme te jemi ne pritje pergjigjeve te parashtruara ne emailin e dates 9.11.2020 dhe prej me shume se dy javesh qe te caktoni vendin dhe postin e punes prane ambjenteve te DPGJC te Auditit, gje qe pengon kryerjen e funksioneve te ngarkuara Kodi Zgjedhor.

Ne piken 6 e nenit 61 te Kodit Zgjedhor, paragrafi i fundit sanksionohet qarte se: ***"Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është e detyruar t'u krijojë kushte pune auditëve për të kryej. auditimin e tyre në mënyrë të pavarur".***

*Sipas diskutimit ne takimit te djeshem posti punes sot do ishte gati , gjithashtu po te parashtroj dhe me email pyetje e bera gjate takimit.*

2. Shtetasit qe kane lene shtetesine Shqiptare a jane pasqyruar ne liste?
3. Sa jane numri i shtetasve qe jane brenda nje trungu familjar qe votojne ne Qendra Votim i te ndryshme? Listen e tyre .
4. Sa jane shtetasit qe jane ne nje trung familjar qe kane adresa te ndryshme ose njesi t e ndryshme?
5. Ndryshimi i Qendrave te Votimit, sa eshte numri i shtetasve qe me kerkese e tyre kane ndruar adresen dhe qendren e votimit nga 2019 deri me daten e sotme?Listen e tyre .

Ju uroj nje dite te mbare.

Me Respekt
**Auditi Teknicien**
Roland Kercuku

[Quoted text hidden]

---

**Bledar Doracaj** <Bledar.Doracaj@mb.gov.al> Thu, Nov 12, 2020 at 2:50 PM
To: Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>
Cc: Vangjush Stavro <Vangjush.Stavro@mb.gov.al>, Shpetim Cokaj <Shpetim.Cokaj@mb.gov.al>, Lealba Pelinku <Lealba.Pelinku@cec.gov.al>

Z. Kercuku,

Nga komumikimi verbal, ju eshte bere me dije qe ju kemi caktuar nje post pune.
Sot Ju kemi pritur ne ambjentet e DPGJC ne MB.
Kurdo qe te keni kohe, mundesi dhe deshire jeni te mirseardhur.

Gjithe te mirat!

Sent from my iPhone

> On 12 Nov 2020, at 2:45 PM, Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com> wrote:
>
> [Quoted text hidden]

---

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar,është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse , përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

Gmail Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>

# Kerkese Audit .

3 messages

**Roland Kercuku** <l.kercuku@gmail.com> Fri, Nov 13, 2020 at 1:18 PM
To: Vangjush Stavro <Vangjush.Stavro@mb.gov.al>
Cc: bledar.doracaj@mb.gov.al, Shpetim.Cokaj@mb.gov.al, lealba.pelinku@cec.gov.al

Përshëndetje Z.Stavro

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe krijim e kushteve normale te punës tone.

1. Ju lutem na bëni me dije :
   a. Ne rastet kur kryen transaksione te cilat direkt ose indirekt lidhet me ndryshimin e adresës se vendbanimit, a reflektohet ky ndryshim ne përditësimin dhe te qendrës te votimit bazuar ne ndryshimin e kodin vendbanimit (si p.sh. ne rastin e martesës qe automatikisht përditëson vendbanimin e bashkëshortes /bashkëshortit)
   b. Na jepni referencat dhe (bashkëngjitur ) aktin ligjor /nënligjor për kryerjen e kësaj procedure.

Ketë kërkese e bëjmë për kuptuar procedurat e zbatuara nga zgjc për ketë çështje.

2. Gjate vëzhgimet e bëra ne RKGJC mbi 100 raste me mos përputhje te qendrës te votimit brenda familjes. Për ketë arsye përveç numrit total do te kërkojmë te kemi te dhëna mbi kodin e familjes për te gjithë listën e votuesve .(ne ekstraktin dy na shtoni dhe kodin e familjes) .

Do ju lutesha për çdo pike ne mënyre individuale për përgjigjen pa pritur qe te plotësoni te gjitha.

Ju uroj pune te mbare.

Me respekt

Auditi Teknicien

Roland Kërçuku

**Vangjush Stavro** <Vangjush.Stavro@mb.gov.al> Fri, Nov 13, 2020 at 1:44 PM
To: Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>
Cc: Bledar Doracaj <Bledar.Doracaj@mb.gov.al>, Shpetim Cokaj <Shpetim.Cokaj@mb.gov.al>, Lealba Pelinku <Lealba.Pelinku@cec.gov.al>

Përshëndetje Z. Kërçuku,

Po ju shkruaj për të njoftuar se jemi duke punuar me pikat që keni parashtruar për informacion.
Të Hënën, datë 16 Nëntor 2020, para orës 14:00, do të merrni përgjigje për të gjitha pikat.
Për të përshpejtuar procesin ju lutem na vendosni në dispozicion dhe rastet e pikës 2 "Gjate vëzhgimet e bëra ne RKGJC mbi 100 raste me mos përputhje te qendrës te votimit brenda familjes".

Faleminderit,

-----------------------------------------------------------------

Vangjush Stavro, MEng

Drejtoria e Sistemeve Informatike / Directory of Information Systems
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile / General Directorate of Civil Status
Ministria e Brendshme / Ministry of Interior

Sheshi Skenderbej, Nr.3, 1001
Tirana, ALBANIA

---

**From:** Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>
**Sent:** 13 November 2020 13:18
**To:** Vangjush Stavro
**Cc:** Bledar Doracaj; Shpetim Cokaj; Lealba Pelinku
**Subject:** Kerkese Audit .

[Quoted text hidden]

---

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar,është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse , përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

---

**Vangjush Stavro** <Vangjush.Stavro@mb.gov.al> Wed, Nov 18, 2020 at 1:55 PM
To: Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>
Cc: Bledar Doracaj <Bledar.Doracaj@mb.gov.al>, Lealba Pelinku <Lealba.Pelinku@cec.gov.al>, Shpetim Cokaj <Shpetim.Cokaj@mb.gov.al>

Përshëndetje Z. Kërçuku,

Më poshtë do të gjeni përgjigjet për çdo çështje të ngritur në e-mail e datës **12 Nëntor 2020** ora **14:45**:

**1. Vazhdojme te jemi ne pritje pergjigjeve te parashtruara ne emailin e dates 9.11.2020 dhe prej me shume se dy javesh qe te caktoni vendin dhe postin e punes prane ambjenteve te DPGJC te Auditit, gje qe pengon kryerjen e funksioneve te ngarkuara Kodi Zgjedhor.**
Posti është vendosur në dispozicion siç jua dëftuam dhe në takimin e ditës së Mërkurë, 11 Nëntor 2020. Ju lutem konfirmoni që kjo pikë është plotësuar sipas nevojës.

**2. Shtetasit qe kane lene shtetesine Shqiptare a jane pasqyruar ne liste?**
DPGJC po vijon me rikontrollin listave për lënien e shtetësisë. Sa të kemi informacionin përfundimtar do t'ju informojmë në lidhje me këtë kërkesë.

**3. Sa jane numri i shtetasve qe jane brenda nje trungu familjar qe votojne ne Qendra Votimi te ndryshme? Listen e tyre .**
Lidhur me rastin e trungjeve familjare po i referoheni zyrës së gjendjes civile të arkivave e cila nuk merr pjesë në hartimin e listave zgjedhore.
Në rast se i referoheni përbërjes familjare ju informojmë se numri i shtetasve që kanë qendra votimi të ndryshme brenda të së njëjtës familje është **576.505**.
Pjesë e këtij numërimi janë dhe shtetas të burgosur me të drejtë vote / oficerë / shtetas që votojnë në qendra votimi të veçanta, të cilëve u ka ndryshuar zgjc si dhe qendra e votimit respektive.
Gjithashtu ngelet për t'u sqaruar se pjesë e këtij numërimi është e gjithë familja në rast se njëri prej anëtarëve u ndryshon zgjc nga të tjerët.

**4. Sa jane shtetasit qe jane ne nje trung familjar qe kane adresa te ndryshme ose njesi te ndryshme?**

Lidhur me rastin e trungjeve familjare po i referoheni zyrës së gjendjes civile të arkivave e cila nuk merr pjesë në hartimin e listave zgjedhore.
Në rast se i referoheni përbërjes familjare ju informojmë se numri i shtetasve që kanë zgjc të ndryshme brenda të së njëjtës familje është **9.695**.
Pjesë e këtij numërimi janë dhe shtetas të burgosur me të drejtë vote / oficerë / shtetas që votojnë në qendra votimi të veçanta, të cilëve u ka ndryshuar zgjc si dhe qendra e votimit respektive.
Gjithashtu ngelet për t'u sqaruar se pjesë e këtij numërimi është e gjithë familja në rast se njëri prej anëtarëve u ndryshon zgjc nga të tjerët.

5. Ndryshimi i Qendrave te Votimit, sa eshte numri i shtetasve qe me kerkese e tyre kanë ndruar adresen dhe qendren e votimit nga 2019 deri me daten e sotme?Listen e tyre.
DPGJC gjatë zgjedhjeve të vitit 2019 ka patur prezent audituesit teknicien të cilëve u është vënë në dispozicion lista përfundimtare e zgjedhësve për zgjedhjet e vitit 2019.
Gjithashtu nga ana jonë, ju është vënë në dispozicion ekstrakti i dytë zgjedhor. Lidhur me informacionin e kërkuar, lutem të bëni krahasimin me të dhënat e vënë në dispozicion.

Më poshtë do të gjeni përgjigjet për çdo çështje të ngritur në e-mail e datës **09 Nëntor 2020 ora 11:57:**

1. Në cilin afat kohor është zhvilluar projekti "Identifikimi dhe popullimi i adresës së shtetasve derë më derë", dhe si është siguruar përditësimi është këtyre deri në ditën e migrimit të 1,380,205 shtetasve.
"Identifikimi dhe popullimi i adresës së shtetasve derë më derë" është realizuar gjatë periudhës kohore Tetor 2016 deri në Maj 2017.

2. Ju deklaroni se mbi 1.8 milion adresa janë ndryshuar me kërkesë të shtetasve? Duke u bazuar në një përllogaritje të vogël rezulton se mbi 15.000 shtetas kanë vizituar zyrat e gjendjes civile çdo ditë (duke përjashtuar 4 muaj e mbylljes për shkak të pandemisë). Ju lutem na vini ne dispozicion numrin e veprimeve të kryera nga çdo zyre e GJC për çdo muaj në lidhje me saktësimin e adresave me kërkesë të shtetasve.
Për sa i përket numrave të deklaruar më lejoni të bëj një korrigjim: **336.626** shtetas kanë përditësuar/saktësuar vendbanimin pranë zyrave të gjendjes civile, ndërsa **1.700.668** shtetas u është saktësuar/përditësuar adresa modelit të adresave të miratuar me udhëzimin e Ministrit të Brendshëm.
Kërkoj ndjesë për çdo paqartësi që mund të ketë krijuar informacioni i raportuar më parë.

3. Ju lutem na saktësoni se çfarë procedurash keni ndjekur gjatë përditësimit (migrimit) të adresave të 1.38 milion shtetasve për:
a. Tu siguruar që këta shtetas nuk kishin kryer asnjë deklarim të adresës (pra nuk përfshiheshin në 1,8 milion rastet e sipërpërmendura.
Procedura e saktësimit/përditësimit të adresave nuk merrte parasysh adresa të përditësuara/saktësuara nga zyrat e gjendjes civile me formatin e ri siç parashikon udhëzimi i Ministrit të Brendshëm, të kryera pas datës së nisjes së këtij procesi.

b. Gjatë procesit të saktësimit të adresës cilat fusha apo elementë të tjerë të gjendjes civile të shtetasve janë përditësuar.
Gjatë procesit të saktësimit të adresës nga projekti "Popullimi" janë saktësuar vetëm 8 elementët e adresës: Bashkia, Njësia Administrative, Qytet/Fshati, Rruga, Ndërtesa, Hyrja, Apartamenti, Kodi Postar. Theksoj se Zyra e Gjendjes Civile dhe përbërësit zgjedhorë të shtetasve nuk janë ndryshuar.

c. Ju lutem na saktësoni se gjatë përditësimit të mbi 3.18 milion adresave a është përditësuar kodi i vendbanimit, në se po mbi bazë të çfarë informacioni në se jo përse?
Kodi i vendbanimit nuk është term i përdorur nga ne. Në rast se i referoheni **kodit të zyrës së gjendjes civile**, jo, nuk është ndryshuar. Në rast se i referoheni **kodi të banesës**, jo, nuk është ndryshuar.
Arsyeja, për të dy këto atribute të shtetasve në RKGJC, është se nuk ekzistonte informacioni i duhur për përditësimin e tyre të saktë. Risku për të krijuar konfuzion në të dhënat e përbërsve zgjedhor, ishte shumë i madh, që të dërmerrej një nismë e tillë.

d. Ju lutem na vini në dispozicion lidhjen që ekziston ndërmjet elementëve të adresës së vendbanimit dhe kodit të vendbanimit.
Aktualisht elementët e adresës nuk lidhen as me kodin e zyrës së gjendjes civile as me kodin e banesës. Po i referohem të dy elementëve duke mos e patur të qartë kujt i referoheni me kod vendbanimi.

4. Në e-mail të datës 05/11/2020 ju theksoni se "realizimi i këtij procesi, u krye pa prekur elementët përbërës të kodit zgjedhor të shtetasve", por me ndryshimin/përditësimin e adresës së vend banimit, detyrimisht duhet të ndryshojë dhe kodi i vend banimit që është përbërës zgjedhor. Ju lutem na saktësoni.

Për përditësimin e të dhënave të vendbanimit të shtetasve shqiptarë në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010, zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative kryejnë veprime për përditësimin e të dhënave të vendbanimit / adresës së shtetasve.

Ndjekja e kësaj veprimtarie nga nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki / njësi administrative theksojmë se është kryer në bazë të përcaktimeve në ligjin nr. 10 129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", të ndryshuar dhe në aktin nënligjor, vendimit nr.1243, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumenteve, që duhet të paraqesin shtetasit e të procedurave, që duhet të kryejnë zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi bashkiake / komuna dhe institucionet shtetërore, të posaçme, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve".

Deklarimi i vendbanimit të shtetasve, si një proces që duhet të kryhet nga shtetasit në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative, sipas dispozitave në ligjin për gjendjen civile duhet të kryhet brenda 30 (ditëve) nga ardhja në vendbanimin e ri.

Për mosrespektimin e këtij afati dispozitat në fuqi, parashikojnë vendosjen e masës administrative, dënimit me gjobë në vlerë 10 000 (dhjetë mijë) lekë, sanksion i cili ka frenuar këtë proces. Duke e konsideruar një vlerë të lartë, një pjesë e shtetasve nuk kanë deklaruar vendbanimin real të tyre.

Ndërkohë që një kategori i caktuar shtetasish nuk janë paraqitur në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative për deklarimin e ndryshimit të vendbanimit, një pjesë e të dhënave të vendbanimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010, ka rezultuar nga zbatimi i projektit "Identifikimi dhe popullimi i adresës së shtetasve derë më derë".

Vlen të theksojmë se shtetasve shqiptarë nuk u janë ndryshuar të dhënat e vendbanimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010. Problematika qëndron se me zbatimin e këtij projekti, për një pjesë të tyre të cilët kanë në pronësi më shumë se një banesë, me migrimin e të dhënave të projektit të popullimit, nga sistemi është nxjerrë automatikisht vendbanimi i tyre dytësor, si vendbanimim kryesor në disa raste.

Rregullimi i këtyre të dhënave është ndjekur rast pas rasti nga nëpunësit e zyrave të gjendjes civile, të cilët me paraqitjen e shtetasve kanë kryer veprime të shkëmbimit të këtij informacioni në sistem, duke lënë si vendbanim kryesor vendbanimin e mëparshëm që këta shtetas kanë patur, të saktësuar me tetë elementë të adresës siç kërkon ligji në fuqi.

Për procesin e rregullimit / saktësimit të adresave janë dhënë orientimet e nevojshme, duke e konceptuar si një proces që kërkon një bashkëpunim më të gjerë me pushtetin vendor. ky bashkëpunim është kërkuar nisur nga problematika të ndeshura, pasi një pjesë të banesave në territorin e Republikës së Shqipërisë, për zona të caktuara nuk rezultojnë të regjistruara në sistemet e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës / Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ndonëse janë të ndërtuara prej kohësh.

Për këto raste bashkëpunimi është kërkuar për lëshimin e konfirmimeve administrative, nga strukturat e posaçme me komunitetin që vërtetojnë ekzistencën në terren të këtyre banesave dhe më pas me zyrat e urbanistikës të cilat kanë dhënë informacionin e nevojshëm për elementët e adresës, si rruga, numri i ndërtesës, kodi posta, dhe hyrja që janë plotësuar në sistemin e RKGJC-së nga nëpunësit e zyrave të gjendjes civile.

Gjithjashtu është trajtuar dhe rasti i banesave në status legalizimi, për të cilat është kërkuar konfirmimi nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës së janë në status legalizimi. Gjithashtu është trajtuar dhe rasti për ato njësi banimi, apartamente, për të cilat nuk është lëshuar vërtetimi i pronësisë. Për këto raste është rekomanduar që veprimet të kryhen mbi bazën e dokumenteve kontratë nga shoqëritë sipërmarrëse, shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga ndërlidhësit me komunitetit, ku konfirmohet se shtetasit banojnë në ndërtesat e përfunduara nga sipërmarrësi, sipas shkresës kopje të së cilës po e dërgojmë bashkëlidhur.

Brenda muajit Nëntor pritet që procesi i deklarimit të vendbanimit, adresës së shtetasve të kryhet on-line, nëpërmjet portalit e-albania.

5. Në e-mail të datës 05/11/2020 ju theksoni se "Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka identifikuar të gjithë shtetasit të cilët kanë adresë të pasaktë në RKGJC dhe shtetasit të cilëve njësia administrative e adresës nuk përputhet me zyrën e gjendjes civile të tyre", A mund të na vihet në dispozicion kjo listë ose minimalisht numrat e këtyre rasteve për çdo Qark/Bashki/ZGjC)?
Bashkëlidhur do të gjeni dokumentin me statistikat për ZGJC.

6. Në e-mail të datës 05/11/2020 ju theksoni se ke filluar një proces ri-saktësimi dhe që korrigjimi i gabimeve/pasaktësive nuk ka kosto për qytetarët, ndërkohe që nuk ka asnjë akt ligjor që shmang pagesën e penalitetit nga ana e qytetarëve.

Si iniciativë ligjore përmendim këtu, projektligjin "Për një ndryshim në ligjin nr. 10 129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", të ndryshuar, i propozuar me iniciativën e një grupi deputetësh me qëllim shfuqizimin e dispozitës, pikës 1, shkronja ç, në nenin 74, ku shprehimisht parashikohet:

"Neni 74

1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e përmendura më poshtë, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë:

ç) shkelja ose mosrespektimi i dispozitës së përcaktuar në pikën 3, të nenit 15, dënohet me gjobë, në masën 10 000 lekë, dhe me pezullim të shërbimit deri në vjeljen e gjobës, të cilën e vendos dhe e vjel nëpunësi i gjendjes civile"

i cili është në proces miratimi.

Ky sanksion administrativ, në një vlerë të konsiderueshme prej 10 000 (dhjetë mijë) lekë, i aplikuar deri më tani nuk ka rezultuar i efektshëm dhe nuk ka gjetur zbatim në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative, përkundrazi është bërë shkas për pengimin e procedurave të deklarimit të vendbanimit nga shtetasit, të cilët edhe pse kanë ndryshuar vendbanimin rezulton se nuk e kanë deklaruar këtë ndryshim në zyrën e gjendjes civile.

Me heqjen e kësaj mase shtrënguese, është tentuar të lehtësohet barra e shtetasve shqiptarë në ofrimin shërbimeve publike sipas një metodologjie të re, me sa më pak kosto në ngarkim të tyre.

Ofrimi i shërbimit me sa më pak kosto nga qytetarët është favorizuar dhe nga dispozitat në ligjin nr. 10 129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht si vijon:

"2. Në rast të lidhjeve familjare të vërtetuara, pranimi i personit apo i familjes në vendbanimin e ri bëhet në bazë të deklarimit të tyre para nëpunësit të zyrës së gjendjes civile, në juridiksionin e së cilës është vendbanimi i familjes pritëse.

3. Strukturat komunitare të bashkisë/njësisë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës ndodhet vendbanimi i ri, kryejnë verifikimet përkatëse, në lidhje me plotësimin e standardeve të sipërfaqes së banimit për frymë. Pas kryerjes së verifikimit, strukturat komunitare përgatisin një raport, i cili është pjesë e praktikës që administron nëpunësi i zyrës së gjendjes civile për këtë qëllim

Për shumë shtetas që realisht banojnë në banesa të të afërmëve të tyre deklarimi është kryer pa kosto përpara nëpunësit të gjendjes civile në bashki / njësi administrative, sipas modelit të deklaratës dërguar bashkëlidhur.

7. Në kërkesën e datës e 03/11/2020 në lidhje me pasqyrimin e Dekreteve të Presidentit të Republikës për marrjen ose lënien e shtetësisë Shqiptare, Ju jeni përgjigjur se jo të gjitha dekretet janë pasqyruar. Në këto kushte po e përsërisim pyetjen në formën e më poshtme:

a. A ekziston mundësia që shtetas Shqiptarë të mos jenë regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) dhe si pasojë të mos jenë pjesë e listës së votuesve, pra të ju mohohet e drejta e votës?

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është ndërmarrë një proces verifikimi lidhur me zbatimin nga zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative të Dekreteve të Presidentit të Republikës për fitimin e shtetësisë shqiptarë.

Nga muaji gusht 2017 deri në shtator 2020, rezulton se 360 prej tyre nuk janë paraqitur në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative për kryerjen e veprimeve të regjistrimit. Procesi i regjistrimit të shtetasve për fitimin e shtetësisë shqiptare kërkon domosdoshmërisht paraqitjen e shtetasve për regjistrim. Kjo lidhet me vullnetin e tyre, pasi në rast të paraqitjes zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative kryejnë menjëherë procedurat e regjistrimit dhe kjo kategori shtetasish të saporegjistruar përfshihet automatikisht në listën e zgjedhësve.

Lidhur me zbatimin e Dekreteve të Presidentit të Republikës për lënie të shtetësisë shqiptare nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk është ndërmarrë proces verifikimi.

Bashkëlidhur do të gjeni informacionin për shtetasit që nuk janë regjistruar pasi u është miratuar dekreti i Presidentit për fitim shtetësie.

b. A ekziston mundësia që shtetas Shqiptarë të cilët kanë lënë shtetësinë të jenë akoma edhe shtetas Shqiptar në RKGjC, dhe si pasojë të kenë të drejtë votimi?

DPGJC po vijon me procesin e kontrollit lidhur me këtë çështje.

Në se ndonjë nga këto raste ekziston, atëherë ju lutem na jepni statistika.

8. Ju lutem a mund të na vini në dispozicion numrin e lindjeve dhe të vdekjeve për çdo Qark sipas çdo muaji të vitit duke filluar nga Janar 2017 e deri me sot.
Bashkëlidhur do të gjeni informacionin për lindjet dhe vdekjet sipas kërkesës.

Gjithashtu jemi në pritje të:

2. Të një informacion më të detajuar për zgjedhësit që kanë ndryshim të QV nga viti 2019 (sipas jush "140.971 - shtetas rezultojnë me përbërës zgjedhor të ndryshuar"
DPGJC gjatë zgjedhjeve të vitit 2019 ka patur prezent audituesit teknicien të cilëve u është vënë në dispozicion lista përfundimtare e zgjedhësve për zgjedhjet e vitit 2019.
Gjithashtu nga ana jonë, ju është vënë në dispozicion ekstrakti i dytë zgjedhor. Lidhur me informacionin e kërkuar, lutem të bëni krahasimin me të dhënat e vënë në dispozicion.

3. A ka ndonjë informacion në lidhje me përditësime/ndryshime të QV si rezultat i shkrirjes së QV me më pak se 300 zgjedhës? Në rast se po ju lutem listën emërore të zgjedhësve të QV të shkrira së bashku me QV ku janë zhvendosur.
Me prezencën tuaj në DPGJC, do t'ju vendosen në dispozicion vendimet e kryetarëve të bashkive për ndarje/bashkim të qendrave të votimit.

---

**Vangjush Stavro, MEng**

Drejtoria e Sistemeve Informatike / Directory of Information Systems
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile / General Directorate of Civil Status
Ministria e Brendshme / Ministry of Interior

Sheshi Skenderbej, Nr.3, 1001
Tirana, ALBANIA

---

**From:** Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>
**Sent:** 13 November 2020 13:18
**To:** Vangjush Stavro
**Cc:** Bledar Doracaj; Shpetim Cokaj; Lealba Pelinku
**Subject:** Kerkese Audit .

Përshëndetje Z.Stavro

[Quoted text hidden]

[Quoted text hidden]

**4 attachments**

Fitim_shtetësie_nga_viti_2017_persona_të_paparaqitur.xls
7K

**lindjet_prej_2017_01_01.ods**
70K

**vdekjet_prej_2017_01_01.ods**
39K

**Numri_shtetasve_me_njesi_administrative_ndryshe_nga_zgjc.ods**
16K

Gmail **Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>**

# Kerkesa Audit

4 messages

**Roland Kercuku** <l.kercuku@gmail.com> Fri, Nov 20, 2020 at 1:22 PM
To: "bledar.doracaj@mb.gov.al" <bledar.doracaj@mb.gov.al>
Cc: "Shpetim.Cokaj@mb.gov.al" <Shpetim.Cokaj@mb.gov.al>, Vangjush Stavro <Vangjush.Stavro@mb.gov.al>, "lealba.pelinku@cec.gov.al" <lealba.pelinku@cec.gov.al>

I nderuar z. Doracaj,

Ne vijim te zbatimit te detyrave ngarkuar nga Kodi Zgjedhor, kerkojme te behemi me dije per proceduren qe ndiqet per hapjen e nje "user" perdorues ne sistemin e Gjendjes Civile per punonjesit e Zyres se Gjendjes Civile dhe se cfare kompetencash e aksesi kane keta punonjes perdorues te sistemit.

Gjithashtu, une si Auditues sebashku me dy ndihmes Audituesat (z.Ilir Stojku dhe z. Laert Kraja), e vleresojme si te nevojshme kryerjen e disa verifikime prane zyrave te gjendjes civile per te mbledhur informacion te vlefshem per hartimin e raportit per KQZ-ne. Mendojme qe kete kontoll ta fillojme mundesisht nga dita e hene, date 23.11.2020 e ne vijim. Lutemi te na mundesoni aksesin e kerkuar prane Zyrave te Gjendjes Civile.

Duke Ju falenderuar per bashkepunimin dhe mirekuptimin,

Me respekt,
Roland Kercuku.

---

**Bledar Doracaj** <Bledar.Doracaj@mb.gov.al> Fri, Nov 20, 2020 at 1:30 PM
To: Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>
Cc: Shpetim Cokaj <Shpetim.Cokaj@mb.gov.al>, Vangjush Stavro <Vangjush.Stavro@mb.gov.al>, Lealba Pelinku <Lealba.Pelinku@cec.gov.al>

Pershendetje,

Percaktoni zyren/zyrat dhe datat respektive per cdo zyre.
Ju bejme me dije se edhe Drejtori i Pergjithshem kur ushtron kontroll, merr miratimin paraprak me shkrim nga Eprori.
Flm

On 20 Nov 2020, at 1:22 PM, Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com> wrote:

[Quoted text hidden]

---

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar,është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse , përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

**Roland Kercuku** <l.kercuku@gmail.com> Fri, Nov 20, 2020 at 3:52 PM
To: Bledar Doracaj <Bledar.Doracaj@mb.gov.al>
Cc: Lealba Pelinku <Lealba.Pelinku@cec.gov.al>, Shpetim Cokaj <Shpetim.Cokaj@mb.gov.al>, Vangjush Stavro <Vangjush.Stavro@mb.gov.al>

I nderuar z. Doracaj,

Ne piken 5, Neni 61, te Kodit Zgjedhor, eshte sanksionuar qarte se "Çdo audit teknicien **ka akses në sistemin elektronik, bazën e të dhënave dhe dokumentacionin e RKGjC-së dhe të zyrave të gjendjes civile**, për të bërë të mundur leximin dhe krahasimin e përbërësve të gjendjes civile, ndryshimeve të tyre, kohën kur janë kryer këto veprime nga përdoruesit apo administratorët e sistemit, si dhe të çdo lloj raporti të sistemit elektronik, të cilat gjurmojnë të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur për përbërësit zgjedhorë në RKGjC për periudhën që kontrollohet, duke përfshirë edhe metodologjinë si gjenerohet ky raport.

Duke qene se aksesin ne dokumentacionin e zyrave te gjendjes civile na i mundeson ligji, ju jemi drejtuar si titullar i institucionit qe te mundesoni bashkepunimin me punonjesit e gjendjes civile. Me poshte po ju bejme me dije datat dhe zyrat e gjendjes civile te cilat vleresojme se duhet te shkojme per kontroll si faze e pare.

E Hene date 23.11.2020 Zyra civile prane Njesise Bashkiake Nr.10 dhe Nr. 7
E Marte date 24.11.2020 Zyra civile prane Njesise Bashkiake Nr. 9
E Merkure date 25.11.2020 Zyra civile prane Njesise Bashkiake Nr. 5
E Enjte date 26.11.2020 Zyra civile prane Njesise Bashkiake Nr. 13
E Premte date 27.11.2020 Zyra civile prane Njesise Bashkiake Nr. 8
[Quoted text hidden]
[Quoted text hidden]

---

**Bledar Doracaj** <Bledar.Doracaj@mb.gov.al> Fri, Nov 20, 2020 at 4:08 PM
To: Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>
Cc: Lealba Pelinku <Lealba.Pelinku@cec.gov.al>, Shpetim Cokaj <Shpetim.Cokaj@mb.gov.al>, Vangjush Stavro <Vangjush.Stavro@mb.gov.al>

Z Kercuku,

Ju lutem paraqisni nje kerkese me shkrim ne DPGJC diten e hene, duke konsideruar 2-3 dite me pas qe te ushtroni verfikime te rasteve te pretenduara ne zgjc.
Edhe njehere Ju bejme me dije, se DPGJC eshte pjese e aparatit te MB dhe si pasoj, eshte organi epror qe miraton autorizimet per verifikimet tuaja ne zyrat e gjendjes civile.
Ju sjellim ne vemendje, qe rastin e pare dhe te vetmin( edhe pse me kerkesa te panumerta para vitit 2013), e kemi realizuar per here te pare ne vitin 2015 dhe 2017.
Ky standart do mundesohet edhe kete here e ne vijim, por duke respektuar afatet dhe aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi.
Vleresoj konstatimin tuaj, dhe ju siguroj mbeshtetjen tone, duke kerkuar te ndiqni proceduren ligjore!
Fundjave te mbare!

Sent from my iPhone
[Quoted text hidden]
[Quoted text hidden]

Gmail

Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>

---

## kerkesa Audit

2 messages

---

**Roland Kercuku** <l.kercuku@gmail.com> Mon, Nov 23, 2020 at 3:06 PM
To: Vangjush Stavro <Vangjush.Stavro@mb.gov.al>
Cc: Lealba Pelinku <lealba.pelinku@cec.gov.al>, Bledar Doracaj <bledar.doracaj@mb.gov.al>, Shpetim Cokaj <Shpetim.Cokaj@mb.gov.al>

Pershendetje Z.Stavro,

Ju lutem me konfirmoni neqoftese keni dokumentacion per :

a. Menaxhimi te roleve dhe pergjegjesve per user ne sistem.
b.Kerkese per fshirjen /Caktivizimin/fshirjen e perdorusit .

1. Udhezimet e Ministrit per perditesimin e adresave dhe per hartimin e listave ai i meparshmi.
2. Lidhja ndermjet ZGJC (tre shifrat e para te kodit 10 shifror) me Nr. QV (kater shifrat e dyta).
3. Ne dijenine tone jane krijuar zyra te reja te gjendjes civile (si psh ne Tirane (L 12, L 13 dhe L 14) a jane paisur me kod te ri keto zyra dhe a reflektohet ne kodin 10 shifror keto kode.
4. Ne baze te ligjit nr 10019 me date 28.12.2008 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE" i ndrryshuar. Ne nenin 45 specifikon si me poshte .Cili eshte kodi i vend banimit qe ne baze te cilit ju beni percaktimin e qendres se votimit per shtetasit.

Neni 45*
**ndryshuar me ligjin nr. 74/2012**
**Përbërësit zgjedhorë**
**Ndryshuar me ligjin 31/2015** 28

---

1. Zgjedhësi identifikohet në RKGJC nga përbërësit zgjedhorë. Përbërës zgjedhorë quhen përbërësit e gjendjes civile si më poshtë:
a) emri;
b) atësia;
c) amësia;
ç) mbiemri;
d) datëlindja;
dh) numri personal i identifikimit;
e) shtetësia;
ë) kodi i vendbanimit.
f) gjinia.*

2. Lista që përdoret nga KQV në procesin e votimit përmban përbërësit e përcaktuar në shkronjat "a", "ç", "d", "dh", dhe "f", të pikës 1, të këtij neni*.

Po ju bej me dije se, sipas pergjigjes tuaj date 20.11.2020 ne kemi depozituar sot kerkesen bashkengjitur.Ju lutem pershpejtoni qe ne te realizojme grafikun e kerkuar brenda javes .

Pune te mbare

Me respekt

Auditi teknik

RolandKercuku

---

**njoftimi.pdf**
97K

---

**Vangjush Stavro** <Vangjush.Stavro@mb.gov.al> Tue, Nov 24, 2020 at 3:34 PM
To: Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>
Cc: Lealba Pelinku <Lealba.Pelinku@cec.gov.al>, Bledar Doracaj <Bledar.Doracaj@mb.gov.al>, Shpetim Cokaj <Shpetim.Cokaj@mb.gov.al>

Përshëndetje Z. Kërçuku,

Më poshtë do të gjeni përgjigjet:

a. Menaxhimi te roleve dhe pergjegjesve per user ne sistem.
b.Kerkese per fshirjen /Caktivizimin/fshirjen e perdorusit .
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile funksionon sipas ligjit të gjendjes civile 10129 i ndryshuar.
Në momentin që punonjësi i zyrës së gjendjes civile largohet nga puna në dosjen e tij depozitohet komunikimi i dorëheqjes ose shkarkimit.
Drejtoria e Sistemeve Informatike vijon me bllokimin e aksesit të përdoruesit.
Theksojmë se përdoruesit nuk fshihen nga RKGJC, thjesht bllokohen.

Vini re se çdo veprim i çdo punonjësi gjurmohet në RKGJC.

**Udhezimet e Ministrit per perditesimin e adresave dhe per hartimin e listave ai i meparshmi.**

Ju lutem jepni më shumë detaje mbi pyetjen. Kujt i referoheni më konkretisht?

**Lidhja ndermjet ZGJC (tre shifrat e para te kodit 10 shifror) me Nr. QV (kater shifrat e dyta).**

Nuk gëzon lidhje kodi i ZGJC me shifrat e QV. Po ju nevojitet informacion tjetër ju lutem detajoni pyetjen.

**Ne dijenine tone jane krijuar zyra te reja te gjendjes civile (si psh ne Tirane (L 12, L 13 dhe L 14) a jane paisur me kod te ri keto zyra dhe a reflektohet ne kodin 10 shifror keto kode.**

Këto zyra janë hapur për amortizimin e fluksit të punës së njësive përkatëse, Njësia 5, Kashar dhe Dajt. Ato përdorin kodin e ZGJC për të cilën është hapur.

**Ne baze te ligjit nr 10019 me date 28.12.2008 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE" i ndrryshuar. Ne nenin 45 specifikon si me poshte .Cili eshte kodi i vend banimit qe ne baze te cilit ju beni percaktimin e qendres se votimit per shtetasit.**

Kodi i vendbanimit është një atribut tekstual të cilin e merr shtetasi në momentin që regjistrohet në ZGJC, ose zhvendos ZGJC.

Ky kod është përcaktuar nga zyra e urbanistikës brenda kufirit të qendrës së votimit përkatëse.

Asnjë element i adresës sipas formatit të ri nuk lidhet me këtë kod, fakt që pasqyrohet qartazi dhe në Nenin që keni dërguar në e-mail.

Punë të mbarë,

---

Vangjush Stavro, MEng

Drejtoria e Sistemeve Informatike / Directory of Information Systems
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile / General Directorate of Civil Status
Ministria e Brendshme / Ministry of Interior

Sheshi Skenderbej, Nr.3, 1001
Tirana, ALBANIA

---

**From:** Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>
**Sent:** 23 November 2020 15:06
**To:** Vangjush Stavro
**Cc:** Lealba Pelinku; Bledar Doracaj; Shpetim Cokaj
**Subject:** kerkesa Audit

[Quoted text hidden]

---

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar,është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse , përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

Gmail Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>

# Kërkimi i informacionit në zyrat e gjendjes civile

2 messages

**Vangjush Stavro** <Vangjush.Stavro@mb.gov.al> Tue, Nov 24, 2020 at 4:12 PM
To: Roland Kercuku <l.kercuku@gmail.com>
Cc: Bledar Doracaj <Bledar.Doracaj@mb.gov.al>, Lealba Pelinku <Lealba.Pelinku@cec.gov.al>, Shpetim Cokaj <Shpetim.Cokaj@mb.gov.al>

Përshëndetje Z. Kërçuku,

